



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 26 regjistër (JR)

Nr. 88 i vendimit

Datë 08.07.2024

Datë 09.12.2025

### VENDIM

### NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 09.12.2025, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Dritan Gripshi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

**OBJEKTI:** Shqyrtimin e vendimit nr. 749, datë 27.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Dritan Gripshi, me detyrë Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

**BAZA LIGJORE:** Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e

mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

### **Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, (në vijim ligji nr. 84/2016), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe parashtrimet shtesë të depozituara në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim Kolegji), sipas të cilave, ai kërkoi përfundimisht prishjen ose ndryshimin e vendimit nr. 508, datë 10.02.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

### **VËREN:**

#### **I. Rrethanat e çështjes**

1. Subjekti i rivlerësimit Dritan Gripshi [në vijim “subjekti i rivlerësimit”] i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim, “KLP”).

1.1. *ILDKPKI-ja*, në përfundim të procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm, sipas të cilit: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

1.2. *AKSIK/DSIK-ja*, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës të subjektit të rivlerësimit, ka përcjellë raportin e vlerësimit<sup>1</sup> për subjektin e rivlerësimit, duke konstatuar *përshstatshmërinë* për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Dritan Gripshi.

1.3. *KLP-ja*, ka dërguar raportin<sup>2</sup> për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit; (ii) tri dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosje penale të përzgjedhura sipas

---

<sup>1</sup> Raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZh-së nr. {\*\*\*} datë 27.03.2023.

<sup>2</sup> Nr. {\*\*\*} prot., datë 17.12.2020.

një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iv) të dhëna nga burimet arkivore të KLP-së, të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

2. Pasi kreu hetimin për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioni, nëpërmjet vendimit objekt shqyrtimi me nr. 749 datë 27.03.2024, konkludoi me masën disiplinore të *shkarkimit nga detyra*. Arsyetimi i Komisionit u bazua në përfundimet e arritura për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe kriterit të vlerësimit profesional, përmbledhur si vijon.
  - a. Subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e *kriterit të kontrollit të pasurisë*, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, të cilat përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Ky vlerësim u bazua në konkluzionet përfundimtare për kriterin e pasurisë se: (i) subjekti i rivlerësimit: ka kryer deklarim të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “a” të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, në shumën rreth 8,2 milionë lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti u vlerësua se ka kryer deklarime të pamjaftueshme për këtë kriter, duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji;
  - b. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm, pasi ka plotësuar në mënyrë të saktë, formularin e deklarimit për kontrollin e figurës dhe nga hetimet nuk ka rezultuar që ai të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar
  - c. Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me shkronjën “c”, të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 e për rrjedhojë, e ka vlerësuar të aftë profesionalisht.

## III. Shkaqet e ankimit

3. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim<sup>3</sup> kundër vendimit të Komisionit. Me ankimin nuk janë depozituar akte. Në datën 04.12.2025 subjekti depozitoi në Kolegj parashtrime shtesë të shoqëruara edhe me akte,<sup>4</sup> duke kërkuar administrimin e tyre në cilësinë e provës. Në ankim dhe

---

<sup>3</sup> Regjistruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot, datë 27.05.2024.

<sup>4</sup> Me parashtrimet, subjekti depozitoi në Kolegj aktet: (i) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 02.12.2025, të deklaruases M. K.; (ii) dy dokumente të titulluara “Transferim nga llogaria në llogari”, të klientit M. K., printuar nga banka BKT, njëri në datën 22.12.2021 dhe tjetri në datën 06.01.2025 [pas dhënies së vendimit]; (iii) dy vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan përkatësisht me nr. {\*\*\*}, datë 27.09.2001 dhe nr. {\*\*\*}, datë 17.10.2003; (iv) konkluzione, datë 11.09.2001, rreth procedimit penal nr. {\*\*\*}; (v) dy informacione njëri pa datë dhe tjetri me datë 10.11.2003, drejtuar ish-Prokurorit të Përgjithshëm për procedimin penal nr. {\*\*\*}/1999; diskutim

në parashtrimet shtesë, subjekti pretendon se procesi i rivlerësimit është kryer në shkelje të rënda procedurale dhe materiale, me fokus hetimin administrativ, gjykimin, mënyrën e arsyetimit të pretendimeve, analizës së fakteve, rrethanave të dala gjatë gjyimit dhe logjikës së gabuar në arritjen e përfundimeve, të cilat i kanë cenuar rëndë të drejtën kushtetuese dhe konventore për një proces të rregullt ligjor.

**3.1.** Vendimi që e shkarkoi nga detyra është i paligjshëm dhe është marrë në shkelje të parimeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, në vlerësim të gabuar të dispozitave të Aneksit të Kushtetutës e të ligjit nr. 84/2016 dhe në vlerësim të gabuar të provave. Bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit kërkon: (i) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, çeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja bashkëlidhur parashtrimeve dhe të çdo prove tjetër që mund të çmohet e nevojshme për verifikimin e plotë të gjendjes faktike; (ii) konstatimin e shkeljeve ndaj tij, të të drejtës kushtetuese dhe konventore për një proces të rregullt ligjor; (iii) ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 749 datë 27.03.2024 duke vendosur konfirmimin në detyrë të ankuesit. Në kërkimet përfundimtare të ankimit, subjekti i rivlerësimit shprehet se e kalon testin e standardit kushtetues të provimit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Ai ka arritur nivel të besueshëm për këtë kriter, duke u ndodhur edhe në kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

**3.2.** Subjekti ka paraqitur në Kolegj edhe një kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës Ina Rama si kryesuese e trupit gjykues. Kjo kërkesë u shqyrtua nga një trupë tjetër gjykuese, e cila me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 05.12.2025, vendosi mospranimin e kërkesës.

4. Në vijim të këtij vendimi, prezantohen në mënyrë të përmbledhur shkaqet e ngritura në ankim dhe në parashtrimet e depozituara në Kolegj, të grupuara në shkaqe me natyrë procedurale, që lidhen me procesin e rregullt ligjor, dhe në shkaqe që lidhen me themelin e vlerësimit të kriterit të pasurisë.

### **III/1. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale**

5. Subjekti pretendon se Komisioni i ka cenuar subjektin të rivlerësimit, të drejtën për të pasur një proces të rregullt ligjor dhe për moscenim të jetës private, të garantuar nga nenet 6/1 dhe 8 të KEDNj-së. Sipas ankuesit, kjo e drejtë është shkelur si rrjedhojë e mosrespektimit nga ana e Komisionit të disa parimeve të së drejtës. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit pretendon:

**5.1.** Komisioni ka vepruar në shkelje të *parimit të sigurisë juridike dhe parimit të ligjshmërisë*, për shkak të mbajtjes ndaj subjektit të një standardi të dyfishtë dhe gjykimeve të kundërta. Në vlerësimin e kriterit të pasurisë, Komisioni nuk ka zbatuar jurisprudencën e organeve të

---

*përfundimtar për çështjen penale ndaj të pandehurve A. B. etj.; (vi) një CD me tri fragmente videosh të transmetuara në televizionin Klan lidhur me procesin gjyqësor me të pandehur A. B. etj.*

rivlerësimit mbi disa çështje me rëndësi vendimtare për ankuesin e konkretisht: (i) për personat e tjerë të lidhur; (ii) për të ardhurat nga toka bujqësore sidomos kur ato u përkasin personave të tjerë të lidhur; (iii) për vlerën e banesave të ndërtuara në mënyrë informale; (iv) për metodologjinë e përlllogaritjes së likuiditeteve *cash* dhe vlerën provuese të deklaratave periodike të pasurisë.

5.2. Vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim me *standardin e proporcionalitetit* të vendosur nga GjEDNj-ja në çështjen Sevdari kundër Shqipërisë, në të cilën kjo gjykatë ka vlerësuar se jo çdo mospërputhje në deklaratat e pasurisë, ose mospërputhje e parëndësishme ndërmjet shpenzimeve dhe burimeve të ligjshme, duhet të pas-sjellë masën më të rëndë disiplinore, atë të shkarkimit nga detyra.

### III/2. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

6. Subjekti i rivlerësimit e kalon testin e standardit kushtetues të të provuarit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Subjekti nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklaram të rremë të pasurisë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave. Komisioni e ka vendosur atë në kushtet e nenit 61, pika 3 të ligjit 84/2016, në interpretim të gabuar të kësaj dispozite, e cila nuk mund të aplikohet në rastin e tij, për sa kohë nuk gjenden dëshmi pozitive se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të dhëna të rreme me qëllim fshehjen e pasurisë. Duke iu referuar vendimit të GjEDNj-së në çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, subjekti pretendon se një masë e tillë disiplinore, vendoset duke u bazuar në prova të forta që lidhen me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit. Vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim me standardin e proporcionalitetit të vendosur nga GjEDNj-ja në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”.

6.1. Subjekti ka ngritur shkaqe ankimi në lidhje me disa pasuri e konkretisht për: (i) një tokë arë, me sipërfaqe 450 m<sup>2</sup>, ndodhur në Sauk, Tiranë; (ii) shtëpinë e banimit në të njëjtën adresë; (iii) shumën 3000 euro, përfituar në vitin 2006 me dhurim nga i vëllai, Sh. G.; (iv) autoveturën tip “Mercedes Benz”, blerë në vitin 2016 në shumën 2100 euro; (v) për një depozitë në emër të bashkëshortes, në Tirana Bank dhe (vi) për analizën financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit 1995 – 2016. Më në detaj, pretendimet konkrete për secilën pasuri, do të trajtohen në vijim të këtij vendimi të Kolegjit.

### IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

#### A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegi

##### A/i. *Juridiksioni i Kolegjit*

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja me objekt shqyrtimi kundërshtimin e vendimit të Komisionit bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit me përbërjen si në pjesën hyrëse të këtij vendimi,

është rezultat i shortit të zhvilluar në datën 16.07.2024<sup>5</sup> dhe i vendimit nr. {\*\*\*}, datë 05.12.2025 të trupit tjetër gjykues që vendosi mospranimin e kërkesës së subjektit për përjashtimin e gjyqtarës Ina Rama.

*A./ii. Legjitimimi i ankuesit*

8. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, duke qenë subjekt rivlerësimi në kuptim të dispozitave kushtetuese e ligjore që rregullojnë këtë aspekt, dhe *ratione temporis*, në kushtet që ankimi është depozituar brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar<sup>6</sup>, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*A./iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit*

9. Pasi analizoi kërkesat procedurale të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vendosi të shqyrtojë ankimin në *dhomë këshillimi*, nën dritën e pikës 1 të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012<sup>7</sup>. Aktet shkresore bashkëlidhur parashtrimeve<sup>8</sup> nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, për rastet përjashtimore që normon ligji për provat e reja që lejohen me ankimin si dhe nuk gjenden as brenda parashikimeve të nenit 49, të po këtij ligji. Për më tepër dhe në një vlerësim të vlerës së tyre, trupi gjykues konstaton se ato nuk janë të nevojshme për zgjidhjen e çështjes, në kuptim të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, nuk konstatohet asnjë prej situatave të parashikuara në nenin 51 të ligjit 49/2012. Ky konkluzion shtjellohet në vijim.

9.1. Për disa prej akteve<sup>9</sup>, të cilat nuk pasqyrojnë të dhëna të prodhuara për herë të parë pasi Komisioni ka dhënë vendimin objekt ankimi, subjekti nuk ka parashtruar pretendime për pamundësi pa faj të tij për t'i depozituar gjatë hetimit administrativ në Komision, ndonëse datojnë përpara vendimit të dhënë. Ndërsa dy akte<sup>10</sup>, ndonëse teknikisht datojnë pas vendimit objekt ankimi, gjithsesi nuk përmbushin kriteret e pranueshmërisë si provë e re me ankimin, pasi ato referojnë veprime të zgjedhura për t'u kryer pas dhënies së vendimit dhe jo fakte/ngjarje/veprime të ndodhura më herët. Edhe duke abstraguuar nga këto konstatime, në kontekstin e përcaktimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, aktet e sjella nga subjekti u gjetën të panevojshme dhe jopërcaktuese për procesin dhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

<sup>5</sup> <https://kpa.al/njoftim-1316/>

<sup>6</sup> *Vendimi i arsyetuar i është njoftuar subjektit të rivlerësimit në datën 16.03.2022.*

<sup>7</sup> *Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.*

<sup>8</sup> *Listuar më lart, në poshtëshënimin nr. 4.*

<sup>9</sup> *Në këtë grup përfshihen akte që datojnë para dhënies së vendimit të Komisionit: (i) dy vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, përkatësisht me nr. {\*\*\*}, datë 27.09.2001 dhe nr. {\*\*\*}, datë 17.10.2003; (ii) konkluzione datë 11.09.2001 rreth procedimit penal nr. {\*\*\*}; (iii) dy informacione, njëri pa datë dhe tjetri me datë 10.11.2003, drejtuar ish Prokurorit të Përgjithshëm, për procedimin penal nr. {\*\*\*}/1999; (iv) diskutim përfundimtar për çështjen penale ndaj të pandehurve A. B. etj., (v) dokument bankar/statement BKT, datë 22.12.2021, sipas të cilit M. K. ka transferuar fondet në shumën 1.800.000 lekë për investim në obligacione 2-vjeçare.*

<sup>10</sup> *Akte që datojnë pas dhënies së vendimit janë: (i) deklarata noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 02.12.2025, e M. K.; (ii) akti i titulluar "Transferim nga llogaria në llogari" të klientit M. K., printuar nga banka BKT në datën 06.01.2025.*

9.2. Së fundmi, nga analiza e kryer në Kolegj rezultoi se në këtë çështje nuk gjen zbatim asnjë nga rrethanat e përcaktuara në ligj,<sup>11</sup> që do të diktonin nevojën për kalimin në seancë gjyqësore publike, në praninë e subjektit. Trupi gjykues nuk evidentoi shkelje të rënda procedurale, apo konstatim të gabuar të situatës faktike, që do të passillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegj, me praninë e subjektit të rivlerësimit, për korigjimin e tyre. Komisioni ka konstatuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë. Për pasojë, vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja nuk nevojitet. Po ashtu, nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni, sikurse as nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision. Për rrjedhojë, shqyrtimi i ankimit të subjektit u krye mbi bazë aktesh, në dhomë këshillimi.

## **B. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit**

### **B.1. Analiza e shkaqeve të ankimit me natyrë procedurale**

10. Sikurse përmbledhur më lart, në kreun III/1, subjekti pretendon se vendimi i Komisionit është produkt i një procesi rivlerësimi të kryer në shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së. Komisioni ka mbajtur ndaj tij një standard të dyfishtë, në shkelje të parimeve të sigurisë juridike dhe ligjshmërisë, për shkak të gjykimeve të kundërta dhe mosrespektimit të jurisprudencës të organeve të rivlerësimit mbi disa çështje me rëndësi vendimtare për ankuesin e konkretisht: (i) për personin *tjetër* të lidhur; (ii) për të ardhurat nga toka bujqësore, sidomos kur bëhet fjalë për persona të tjerë të lidhur; (iii) për vlerën e banesave të krijuara në mënyrë informale; (iv) mënyrën e përlllogaritjes së gjendjes *cash*, sipas deklaratimit në deklaratën *vetting* por edhe në interpretim të saktë të deklaratave periodike vjetore të pasurisë.

10.1. Trupi gjykues i Kolegjit i gjen tërësisht të pabazuara pretendimet e mësipërme. Nga analiza e akteve në fashikull nën dritën e dispozitave kushtetuese e ligjore që gjejnë zbatim, rezulton se procesi i rivlerësimit të subjektit është kryer në përputhje me garancitë e tij kushtetuese dhe konventore për proces të rregullt ligjor, përfshirë edhe sa rezulton nga jurisprudenca e GjEDNj-së për këtë qëllim. Në analizën mbi të cilën bazohet ky konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit së pari thekson se subjekti nuk tregon ndonjë motiv të qenësishëm që mund të ketë ndikuar trupin gjykues të Komisionit për të aplikuar ndaj tij një standard të dyfishtë, duke i rënduar pozitën në lidhje me kriterin e pasurisë. Nga ana tjetër, nuk evidentohen episode ku Komisioni të ketë mbajtur standard të dyfishtë dhe në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit. Përkundrazi, Komisioni e ka

---

<sup>11</sup> Neni 51 i ligjit nr. 49/2012 përcakton: “[1.] Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. [...]”.

favorizuar subjektin në disa çështje, duke pranuar pretendime të sjella rishtazi gjatë procesit të hetimit administrativ apo pasi subjekti është njohur me gjetjet nëpërmjet barrës së provës. Nga ana tjetër, paralelizmi që vendos subjekti ndërmjet rastit të tij dhe subjekteve të tjerë, nuk mund të argumentohet si njëanshmëri. Çdo çështje paraqet fakte dhe rrethana specifike. Më në detaj, këto pretendime analizohen gjatë shqyrtimit të pretendimeve të themelit për pasuritë konkrete të potencuara, por në këtë kontekst pretendimesh me natyrë procedurale, trupi gjykues vlerëson si vijon:

**10.1.1.** Subjekti e vlerëson si njëanshmëri dhe standard të dyfishtë, konkluzionin e Komisionit për depozitën e bashkëshortes me të atin. Sipas tij, Komisioni nuk e ka konsideruar depozitën bankare si pasuri të fshehur të subjektit, ndërsa e ka konsideruar vjehrrin si person tjetër të lidhur, në kundërshtim me pikën 14, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 dhe me jurisprudencën e Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në kushtet që depozita në fjalë është llogari e *përbashkët* e bashkëshortes së subjektit dhe e babait të saj, hetimi i mundësisë financiare të vjehrrit të subjektit të rivlerësimit për të krijuar këtë depozitë bankare – të padeklaruar në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratat periodike vjetore, pavarësisht faktit që bashkëshortja e subjektit figuron bashkëtitullare – është bërë në kuadër të dyshimeve për pasuri të fshehur të subjektit dhe personit të lidhur/bashkëshortes së tij. Po ashtu, Komisioni nuk e ka cilësuar vjehrrin e subjektit person tjetër të lidhur. Mbi të gjitha, në linjë me qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit, nën dritën e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, organet e rivlerësimit kanë për detyrë të hetojnë për pasuri të dyshuara të fshehura të subjekteve të rivlerësimit, edhe kur marrëdhënia konkrete në analizë nuk i përket një prej kategorive të cilat përfshihen në rrethin e personave të tjerë të lidhur me subjektet. Hetimi administrativ i rivlerësimit, në këto lloj rastesh, përjashton [ose konfirmon] dyshimet për pasuri të subjekteve të rivlerësimit, të fshehura pas veprimeve juridike që nga pikëpamja formale pasqyrojnë të tjera fakte e rrethana. Për rrjedhojë, hetimi i kryer nga Komisioni ka qenë në përputhje me këtë orientim të Kolegjit në vendime të mëparshme. Kjo është edhe arsyeja për të cilën Komisioni ia ka ngarkuar balancën negative financiare subjektit dhe bashkëshortes. Nga ana tjetër, në kushtet që Komisioni pavarësisht nga qasja në terma financiarë, nuk e ka shoqëruar atë me narrativën që i përkiste – si pasuri e fshehur e subjektit – trupi gjykues e korrektoi këtë inkoherencë në favor të garancive procedurale që vijnë me ankimin, duke ngarkuar subjektin e bashkëshortes vetëm me gjysmën e prezumuar të balancës financiare që shoqëron këtë pasuri. Analiza e shtjelluar e efektit të kësaj pasurie pasqyrohet në vijim. Në këndvështrimin procedural, trupi gjykues çmon të theksojë se në kushtet që Komisioni ka hetuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe orientimin e Kolegjit, dhe mbi të gjitha, që është në diskutim një pasuri që *është edhe në emër* të bashkëshortes së tij, dhe e padeklaruar, argumenti për cenim të parimit të sigurisë juridike dhe të ligjshmërisë është i pakuptimtë.

**10.1.2.** Edhe për sa u përket të ardhurave nga toka bujqësore, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstaton që qëndrimi i Komisionit të ketë devijuar nga jurisprudenca e Kolegjit. Vendimet e referuara në ankim, nuk janë identike me rastin e subjektit. Kolegji ka pranuar të ardhurat sipas akteve të rivlerësimit, rast pas rasti, duke i vlerësuar këto akte jo të vetme, por në harmoni me aktet e tjera të

administruara gjatë hetimit administrativ të subjekteve respektivë. Shtjellimi më në detaj i këtij pretendimi do të trajtohet në vijim të vendimit, në shkakun ankimor për pasurinë tokë arë, ndodhur në Sauk, Tiranë.

**10.1.3.** Edhe vlera e banesës të ndërtuar nga subjekti në mënyrë informale, në kushtet e mungesës së një situacioni/preventivi të kohës që referon një vlerë konkrete, është përlogaritur nga Komisioni duke u bazuar në çmimet e referencës të përcaktuara në aktet nënligjore të kohës të Entit Kombëtar të Banesave, duke zbritur vlerën e fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit.

**10.1.4.** Së fundmi, përlogaritja e gjendjes *cash* nuk rezulton të jetë kryer në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit. Edhe këto aspekte do të shtjellohen gjatë analizës në vijim, për shkaqet konkrete të ankimit.

## **B.2.** Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë

### **B.2.1.** Shkaqe të përgjithshme që lidhen me aspektin procedural e ligjor të hetimit dhe vlerësimit të kriterit të pasurisë

- 11.** Nëpërmjet shkaqeve të ankimit, subjekti i rivlerësimit potencon aspektin procedural e material të kontrollit dhe vlerësimit të pasurisë. Konkretisht ai shprehet se: (i) e kalon testin e standardit kushtetues të provimit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë, pasi nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklaram të rremë të pasurisë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave. Neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 nuk mund të gjejë zbatim në rastin e tij, për sa kohë nuk gjenden dëshmi pozitive se ka paraqitur të dhëna të rreme, me qëllim fshehjen e pasurisë. Duke iu referuar vendimit të GjEDNj-së në çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, subjekti pretendon se një masë e tillë disiplinore vendoset bazuar në prova të forta që lidhen me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit. (ii) Vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim me standardin e proporcionalitetit të vendosur nga GjEDNj-ja në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”.

**11.1.** Sikurse shtjellohet në vijim për aspektet konkrete të pasurisë të potencuara në ankim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson në kontekstin procedural se pretendimet e mësipërme të subjektit janë të pambështetura në ligj e akte, në jurisprudencën e GjEDNj-së dhe atë të Kolegjit. Në vendime të mëparshme Kolegji u ka dhënë përgjigje në mënyrë konsistente e të përsëritur, argumentave identike me ato të subjektit. Duke e gjetur për rrjedhojë të panevojshme të ripërsërisë ato argumente, trupi gjykues rikonfirmon sa ka arsyetuar në vendime të mëparshme, e konkretisht që leximi harmonik i neneve 61, pika 3, dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, përcakton detyrimin për subjektin e rivlerësimit që të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, në zbatim të përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Neni 61 parashikon gjashtë rrethana ligjore, autonome nga njëra tjetra, dhe që passjellin shkarkimin, nëse vërtetohen. Për shkak të drejtimit të qartë që Aneksi i Kushtetutës jep për secilin nga kriteret, nuk mund të argumentohet se deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë duhet të interpretohet në mënyrë kumulative, e të

kushtëzohet me probleme të kontrollit të figurës për të vërtetuar deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Deklarimi i pamjaftueshëm nuk është pasojë e përmbushjes së disa kriterëve njëkohësisht.

11.2. I pabazuar është edhe pretendimi tjetër se në rastin e subjektit duhet të kishte gjetur zbatim standardi i proporcionalitetit i vendosur nga GjEDNj-ja në çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”. Përpos faktit që asnjë nga problematikat e konstatuara në rastin e subjektit të rivlerësimit Dritan Gripshi nuk ka ngjashmëri qoftë edhe të zbehtë me rrethanat faktike e ligjore të çështjes së subjektit A. Sevdari, problematika e mungesës së burimeve të ligjshme dhe balancat negative financiare për krijimin e pasurisë, sikurse arsyetohet në vijim, janë domethënëse. Për pasojë, masa disiplinore e shkarkimit është në proporcionalitet të plotë me këtë situatë. Balanca negative relativisht e ulët që ka rezultuar për ndonjë pasuri, mund të vlerësohet nën dritën e proporcionalitetit, vetëm nëse do të ishte e vetmja për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Në kushtet që Komisioni ka konstatuar se subjekti kishte një balancë negative prej (-) 8,1 milionë lekë (rumbullakosur) për krijimin e pasurive dhe përbalimin e shpenzimeve, ky argument është i pabazuar. Për më tepër, edhe pas korrektimit të kryer në Kolegj në konsideratë të garancive procedurale me ankimin, gjithsesi subjekti rezulton me një balancë negative të konsiderueshme prej (-) 6,5 milionë lekë (rumbullakosur), e cila e bën të pamundur edhe teorikisht diskutimin për proporcionalitet.

### **B.2.2. Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e pasurive**

#### *I. Pasuria tokë arë në Sauk, Tiranë.*

12. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar pronësinë e tij mbi një tokë bujqësore të llojit arë, me sipërfaqe 450 m<sup>2</sup>, ndodhur në Sauk, Tiranë, blerë prej tij kundrejt çmimit 1.950.000 lekë sipas kontratës noteriale<sup>12</sup> datë 24.12.2005. Subjekti ka deklaruar se të ardhurat që shërbyen si burim për blerjen e kësaj pasurie, ishin kursime nga rroga dhe një hua me vlerë 1,2 milionë lekë marrë një miku të tij [z. S. V..]

12.1. Në bazë të rezultatit financiar negativ prej (-) 2.336.019 lekësh për vitin 2005, Komisioni ka konkluduar se nuk u provuan burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Ky vlerësim përfundimtar erdhi si rrjedhojë e mospërmbysjes së rezultateve të hetimit administrativ sipas të cilave: (i) huadhënësi *nuk* ka disponuar mjaftueshëm burime të ligjshme, për të kontribuar me shumën 1,2 milionë lekë; (ii) subjekti nuk ka disponuar të ardhura të mjaftueshme për të krijuar në fund të vitit 2005 gjendjen *cash* prej 800.000 lekësh, deklaruar në deklaratën periodike të atij viti; (iii) subjekti nuk ka disponuar mjaftueshëm të ardhura për të krijuar kursimet nga pagat, në shumën 750.000 lekë.

12.2. Subjekti i rivlerësimit, kundërshton në tërësi konkluzionet e mësipërme dhe potencon një analizë financiare për gjithë vitin 2005 sipas të cilës ai rezulton me një balancë negative të ulët, prej (-) 186.053 lekësh, e cila nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore. Subjekti pretendon në mënyrë të përmbledhur si vijon: (i) Huadhënësi ka pasur të ardhura të ligjshme, huaja është

<sup>12</sup> Kontrata e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.12.2005, me palë blerëse subjektin e rivlerësimit.

dokumentuar me deklaratë noteriale në vitin 2005 dhe është deklaruar në deklaratën periodike vjetore dhe në deklaratën *vetting*; (ii) Gjatë vitit 2004, subjekti/ankuesi ka përfituar edhe një shpërblim për shkak të një çështjeje penale të vështirë. Këtë shpërblim ai nuk mund ta dokumentojë; (iii) Kursimet në vlerën 800.000 lekë nga pagat, të deklaruara në deklaratën për vitin 2005, nuk duhen përfshirë në analizën e vitit 2005 si gjendje *cash*, sikurse ka vepruar Komisioni në shkelje të parimit të sigurisë juridike dhe duke zbatuar një standard të ndryshëm nga subjektet e tjerë të rivlerësimit. Leximi harmonik i deklaratës *vetting*, me deklaratimet në deklaratat periodike të viteve 2005, 2007 dhe me shpjegimet gjatë hetimit administrativ, të çon në konkluzionin se këto fonde janë përdorur për blerjen e tokës atë vit; (iv) Analiza financiare e vitit 2005 është e pasaktë, pasi në të nuk duheshin përfshirë shpenzimet mjekësore për vajzën, të cilat janë kryer në vitin 2006, dhe as shpenzimet e qëndrimit në Stamboll (Turqi) në vitin 2005, pasi subjekti ka qëndruar në banesën e një të afërmi.

**12.3.** Trupi gjykues i Kolegjit i gjeti të pambështetura pretendimet e subjektit për këtë pasuri. Pas kontrollit të ushtruar mbi analizën financiare të Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme, për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie dhe përballuar shpenzimet në vitin 2005, duke u ndodhur për rrjedhojë në kushtet e nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016. Nga kontrolli i ushtruar vendimit të Komisionit në Kolegj, brenda kufijve të shkaqeve të ankimit e pa cenuar qasjen favorizuese që rezulton për disa aspekte, rezultuan problematika në të dy burimet e deklaruara për krijimin e kësaj pasurie dhe u konfirmua balanca negative prej (-) 2.336.019 lekësh e konstatuar nga Komisioni. Në vijim shtjellohet në detaj, situata faktike e ligjore që rezultoi nga shqyrtimi i pretendimeve të subjektit dhe i akteve të administruara në dosje, analizuar nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim.

(i) *Pretendime në lidhje me huanë 1,2 milionë lekë*

**12.4.** Subjekti ka deklaruar këtë hua në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën periodike për vitin 2005. Sipas shpjegimeve në ILDKPKI<sup>13</sup> dhe gjatë hetimit administrativ në Komision,<sup>14</sup> subjekti ka lidhje shoqërore me huadhënësin. Sipas subjektit, meqenëse ai i kishte depozituar kursimet e veta me një afat të caktuar maturimi në bankë, i kërkoi huadhënësit shumë në fjalë, për një afat kohor prej 4 muajsh, që lidhej me afatin e maturimit të depozitës. Huadhënësi ka pasur një *business* privat në fushën e termoizolimit. Në mbështetje të këtyre shpjegimeve, subjekti ka depozituar dokumentacion gjatë hetimit administrativ<sup>15</sup> dhe në shpjegimet shtesë<sup>16</sup> ka pretenduar se

<sup>13</sup> Në procesverbalin e datës 08.02.2016 të mbajtur në ILDKPKI.

<sup>14</sup> Në pyetësin standard dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 2, përgjigja nr. 4/ii.

<sup>15</sup> Me përgjigjet e pyetësorit standard dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka depozituar ndër të tjera aktet: (i) deklaratën noteriale datë 15.12.2005 të S. V.; (ii) fletën e kërkimit në regjistrin tregtar të QKB-së; (iii) vendimin e Gjykatës së rrethit Gjyqësor Elbasan për regjistrimin e personit fizik S. V.; (iv) vërtetim vjetërsie për personat fizikë dhe vërtetim për bazën e vlerësuar, lëshuar nga ISSh Elbasan në datën 15.08.2023 për vitet 2005, 2006 dhe 2007; (v) vërtetim datë 20.09.2023 i Bashkisë Elbasan për taksat dhe tarifat vendore të personit fizik në emër të huadhënësit.

<sup>16</sup> Shpjegimet shtesë, vijim i pyetësorit nr. 2 (nr. {\*\*\*} prot., datë 08.01.2024).

huadhënësi ka zhvilluar edhe *aktivitet bujqësor*. Për të provuar këto shpjegime subjekti ka dorëzuar dokumentacion.<sup>17</sup>

12.5. Komisioni ka konstatuar se të ardhurat e huadhënësit për periudhën përpara dhënies së huasë nuk u provuan<sup>18</sup>. Gjatë vitit 2005, huadhënësi ka deklaruar kontribute për pagë minimale, dhe nuk rezultoi të ketë pasur gjendje në llogari dhe as të ketë kryer transaksione/tërheqje *cash* deri në dhjetor. Në prapësim të barrës së provës subjekti pretendoi: (i) se huadhënësi kishte përfituar të ardhura edhe nga shërbimet për një person juridik [“{\*\*\*}” ShA] gjatë viteve 2004 – 2008, me vlerë punimesh 1.070.720 lekë për vitin 2004 dhe 1.128.220 lekë për vitin 2005; (ii) huadhënësi përfshihej në kategorinë e tatimpaguesve me qarkullim deri në 2.000.000 lekë, të cilët nuk kishin detyrim për deklarimin e fitimit dhe i kërkoi Komisionit të llogarisë fitimin neto në 30% të qarkullimit deri në kufirin prej 2.000.000 lekësh; (iii) përveç të ardhurave nga ushtrimi i aktivitetit si person fizik, huadhënësi ka realizuar të ardhura edhe nga veprimtaria *bujqësore* dhe e frutikuturës në tokën e tij, sipas vlerave të përllogaritura nga eksperti i zgjedhur prej tij.

12.6. Në analizën financiare përfundimtare të Komisionit, huadhënësi rezultoi me pamundësi financiare për dhënien e huasë, duke mos u përfshirë në analizën financiare si e tillë për pasurinë objekt analize. Komisioni pranoi përllogaritjen e fitimit neto në masën 30% të qarkullimit vjetor deri në 2.000.000 lekë, duke konkluduar që edhe nga kjo përllogaritje, fitimi neto i huadhënësit për periudhën 2004 – 2005 ka qenë jo më shumë se 1.200.000 lekë. Komisioni ka njohur dhe përfshirë në analizë financiare vetëm pagën e bashkëshortes si e vetëpunësuar në bujqësi.

12.7. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe në analizën e kryer në kontroll të vendimit të Komisionit, huadhënësi rezultoi në pamundësi për të financuar kontributin *1,2 milionë lekë hua. Së pari*, duke abstraguar nga fakti që subjekti ka ri-parashtuar në ankim pretendime të cilat janë pranuar nga Komisioni, sikurse është përllogaritja e fitimit të personit fizik në emër të huadhënësit në masën 30 % të qarkullimit vjetor prej 2.000.000 lekësh, nën dritën e garancive procedurale që gëzon subjekti në ankim – trupi gjykues nënvizon se, edhe duke pranuar qasjen favorizuese<sup>19</sup> të

---

<sup>17</sup> Me shpjegimet shtesë, vijim i pyetësorit nr. 2 (datë 08.01.2024), subjekti ka depozituar: (i) akt ekspertimi mbi llogaritjen e ardhurave nga pronësia bujqësore për familjen V., për periudhën 1 gusht 1991 – 31 dhjetor 2005; (ii) fotografi toke dhe 4 certifikata pronësie për pasuritë; (iii) vërtetim datë 12.12.2023 i Njesisë Administrative Shërgjin; (iv) vërtetim datë 12.12.2023 i Bashkisë Elbasan.

<sup>18</sup> Nga shkresat datë 02.11.2023 dhe datë 26.10.2023, përcjellë Komisionit nga DRT Elbasan dhe QKB, rezultoi se: (i) huadhënësi është regjistruar si person fizik, në bazë të vendimit datë 09.04.2004 të gjykatës së rrethit gjyqësor Elbasan e po ashtu figuron i regjistruar si person fizik për një aktivitet në fushën e transportit të mallrave të ndryshme. (ii) sipas konfirmimit të DRT Elbasan, S. V. rezultoi i regjistruar për aktivitetin e transportit të mallrave dhe është mbajtes i përgjegjës për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe i kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore si i vetëpunësuar (i vetëm). Referuar deklaratave për tatim-fitimin e thjeshtuar për vitet 2005, 2006 dhe 2007 bashkëlidhur shkresës së DRT Elbasan, të ardhurat dhe fitimi për vitin 2005, janë deklaruar 0 (zero) lekë, ndërsa sipas deklaratave të sigurimeve shoqërore bashkëlidhur shkresës, huadhënësi ka deklaruar pagën minimale për vitin 2005.

<sup>19</sup> Subjekti nuk ka depozituar akte që dëshmojnë se përfshihej në kategorinë e personave fizikë me xhiro vjetore nën 2 milionë lekë. Nga ana tjetër, sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2023 të përcjellë në Komision nga DRT Elbasan, ndër të dhënat që referohen për personin fizik S. V., përshkruhen edhe përgjegjësitë e tij tatimore e

Komisionit për të përllogaritur fitimin nga aktiviteti privat i huadhënësit në vlerën ekuivalente të 30% të qarkullimit vjetor, pretenduar për herë të parë pasi subjektit i kaloi barra e provës, huadhënësi gjithsesi rezulton me pamundësi financiare për të përballuar shpenzimet e jetesës dhe kontribuuar vlerën e pretenduar hua.

**12.8.** Komisioni e ka favorizuar subjektin në analizën e kryer për mundësinë financiare të huadhënësit edhe nëpërmjet pranimit të të ardhurave nga aktiviteti bujqësor i ushtruar nga bashkëshortja, ndonëse aktet provuese dhe ky pretendim është paraqitur gjatë procesit të hetimit administrativ, madje edhe në seancën dëgjimore. Mbi të gjitha, këto akte paraqesin probleme besueshmërie pasi detyrimet për kontributet e derdhura për efekt të sigurimeve shoqërore rezultojnë të jenë shlyer për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar – në kushtet që subjekti ka qenë i ndërgjegjshëm se duhet të provonte të ardhurat e këtij personi tjetër të lidhur, për shkak të huasë së deklaruar në deklaratën *vetting*. Konkretisht, vërtetimet e lëshuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSh) për bashkëshortët V., sjellë nga subjekti në seancën dëgjimore<sup>20</sup>, referojnë pagesa të kontributeve për bashkëshorten e huadhënësit që datojnë në vitet 2017, 2018, dhe për vetë huadhënësin vetëm në vitin 2020. Në kushtet që në analizë ngrihen pyetje për të ardhura të gjeneruara nga ky aktivitet duke filluar nga viti 1994 – 2005, pavarësisht hendeikut kohor të konsiderueshëm që përbën momenti kur janë kryer pagesat krahasuar me kohën kur janë gjeneruar të ardhurat, përkatësisht për periudha kohore prapavepruese që variojnë nga 13 – deri në 26 vjet, apo që pagesat janë kryer *gjatë procesit të rivlerësimit*, është e pamundur të mos vërehet qartazi që pagesa e kontributeve, që daton vetëm duke filluar nga *korriku 2017* e në vijim, lidhet me krijimin e institucioneve të rivlerësimit dhe nisjen e procesit të rivlerësimit kalimtar.

**12.9.** Kjo rrethanë do t'i bënte të ardhurat e pretenduara nga vetëpunësimi në bujqësi në kohën kur huaja është dhënë, të paprovuara në asnjë formë, edhe duke abstraguuar nga kriteri i ligjshmërisë në kuptim të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës. Për këto shkaqe, trupi gjykues i Kolegjit, vëren se këto të ardhura nuk janë të besueshme se kanë ekzistuar realisht në një masë që mundësonte edhe huadhënien në favor të subjektit në periudhën kohore në fjalë. Kolegji ka mbajtur qëndrim orientues<sup>21</sup> në lidhje me rolin e pagesave me vonesë të detyrimeve ndaj buxhetit të shtetit, për efekt të legjitimitetit të të ardhurave të krijuara, duke vlerësuar ndër të tjera se, pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. Komisioni shprehet se ka pranuar pagën minimale si e vetëpunësuar

---

*konkretisht: (i) për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin që nga data 04.02.2004 dhe (ii) për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që nga data 07.03.2005. Pas barrës së provës, u pranua pretendimi për ta konsideruar këtë person fizik si subjekt me xhiro deri 2 milionë lekë e që përjashtohet nga detyrimi për deklarimin e fitimit, ndonëse aktet e sjella nga DRT Elbasan referojnë të kundërtën.*

<sup>20</sup> *Subjekti i rivlerësimit ka depozituar dy vërtetime “Për të vetëpunësuarit në bujqësi”, lëshuar në datën 25.03.2024, nga ISSh Elbasan, për huadhënësin dhe bashkëshorten e tij. Sipas këtij dokumentacioni, periudhë sigurimi për huadhënësin është 01.01.2000 – 31.12.2003, ndërsa për bashkëshorten e tij është periudha 01.01.1994 – 31.12.2017.*

<sup>21</sup> *Vendimi nr. 15, datë 18.06.2021, pika nr. 23, që i përket subjektit të rivlerësimit Kastriot Selita.*

në bujqësi, *vetëm për bashkëshorten*, ndërkohë që nuk arsyeton nëse i ka pranuar të ardhurat e huadhënësit si i vetëpunësuar në bujqësi.

**12.9.1.** Sa më sipër, Komisioni rezulton ta ketë favorizuar subjektin e rivlerësimit, duke përfshirë në analizën e mundësisë financiare të huadhënësit të ardhura sipas kërkesës së subjektit duke iu referuar këtyre akteve. Megjithatë, në kushtet që Komisioni i ka pranuar të ardhurat si të vetëpunësuar dhe nën dritën e garancive procedurale që gëzon subjekti në ankim, edhe në analizën financiare të kryer në Kolegj për mundësinë e dhënies së huasë, u përfshinë të ardhurat në nivelin e pagës minimale<sup>22</sup> si të vetëpunësuar në bujqësi për të dy bashkëshortët V., për periudhën 1994 - 2005. Edhe në këtë version, analiza financiare për mundësinë e dhënies së huasë prej 1,2 milionë lekësh nga S. V. për vitet 1994 - 2005, rezultoi sërish negative në balancën (-) 428.998 lekë. Nën dritën e garancive procedurale me ankimin, trupi gjykues i Kolegjit i mbajti në konsideratë këto rrethana vetëm si një ndër aspektet e mungesës së besueshmërisë së ekzistencës së burimeve të ligjshme të mjaftueshme të huadhënësit, për të kontribuar në favor të subjektit me shumën e pretenduar të dhënë hua.

**12.10.** Pretendimi se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit<sup>23</sup> në lidhje me të ardhurat bujqësore, është gjithashtu i pabazuar. Dokumentet e vetme të depozituara nga subjekti janë vërtetimet e kontributeve shoqërore të bashkëshortëve V. si të vetëpunësuar në bujqësi, të cilat Komisioni i ka pranuar, ndonëse rezultuan me probleme të besueshmërisë. Nga ana tjetër, dhe duke abstraguuar nga sa është referuar më sipër për favorizim të subjektit nga Komisioni, vlera e të ardhurave të pretenduara nga veprimtaria bujqësore e huadhënësit/huadhënësve i referohet vetëm një akti ekspertimi bujqësor, të përpiluar *gjatë* procesit të rivlerësimit. Në çështje të tjera, Kolegji ka pranuar pretendime për të ardhura nga bujqësia mbi bazën e një sërë aspektesh të ndërthurura, duke vlerësuar aktet/ekspertizën e hartuar rishtazi në harmoni me akte të tjera, kur ushtrimi real i veprimtarisë bujqësore dhe gjenerimi i të ardhurave është provuar me dokumentacion të kohës, si fatura, mandat-pagesa, deklarata të kohës që provonin grumbullimin/tërheqjen/blerjen për përpunim të produkteve bujqësore të prodhuara nga fermerët.

**12.11.** Në ndryshim nga ato çështje referuar nga subjekti si mbështetje të pretendimeve të tij, aktet e sjella prej tij për këtë zë të ardhurash, janë deklarative/hipotetike dhe janë hartuar gjatë procesit të rivlerësimit. Të ardhurat e pretenduara bazohen mbi të dhëna statistikore/teorike të derivuara nga deklaratimet e huadhënësit e familjarëve të tij gjatë procesit të rivlerësimit. Subjekti nuk ka depozituar *asnjë dokument të kohës* që provon realizim të ardhurash nga veprimtaria bujqësore qoftë dhe vetëm në planin *ekzistencial* të tyre. Për rrjedhojë, trupi gjykues konfirmon edhe në këtë

---

<sup>22</sup> Të ardhurat nga vetëpunësimi në bujqësi u llogaritën në vlerën 4.500 lekë në muaj bazuar në VKM nr. 385, datë 31.5.2005, sipas të cilës specifikohet se paga minimale bazë, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve për të vetëpunësuarit në bujqësi është në këtë vlerë.

<sup>23</sup> Subjekti ka referuar si jurisprudencë vendimin e Komisionit nr. 234, datë 04.02.2020 që i përket subjektit të rivlerësimit Miliana Muça si edhe vendimin e Kolegjit nr. 20, datë 14.06.2022 që i përket subjektit të rivlerësimit Irena Gjoka.

aspekt balancën negative të konstatuar në Komision, për pamundësinë e personit tjetër të lidhur për të dhënë huanë subjektit, në vlerën (-) 368.139 lekë. Kjo balancë do të ishte shumë më e thellë nëse analiza do të ishte kryer bazuar në aktet e kohës dhe jurisprudencën e Kolegjit.<sup>24</sup>

(ii) *Pretendime për burimin “kursime familjare”*

12.12. Në deklaratën *vetting*, subjekti i ka deklaruar kursimet nga rroga si një ndër burimet e përdorura për blerjen e tokës në Sauk. Në deklaratën për vitin 2005, subjekti ka deklaruar se ka kursyer vlerën 800.000 lekë, por pa e lidhur atë me blerjen e tokës në Sauk, as në mënyrë indirekte, ndryshe nga sa ka deklaruar në të njëjtin formular për huanë e sipëranalizuar. Në deklaratën për vitin 2006, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*, dhe as pakësimin e vlerës së deklaruar një vit më herët, ndërsa në deklaratën për vitin 2007, subjekti ka deklaruar: (i) një gjendje *cash* në vlerën 2.450.000 lekë, me burim të ardhurat nga shitja e apartamentit, dhe (ii) një tjetër gjendje *cash* në vlerën 600.000 lekë, me burim kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Disa muaj pas dorëzimit të kësaj deklarate, në korrik 2008, subjekti ka rikonfiguruar në ILDKPKI<sup>25</sup> burimet e krijimit të gjendjes *cash*, duke u shprehur se vlera 2.450.000 lekë është krijuar nga: (i) gjendja *cash* prej 800.000 lekësh e pasqyruar në deklarin e mëparshëm, dhe nga (ii) gjendja *cash* prej 1.650.000 lekë e krijuar në vitin 2007, nga shitja e apartamentit. Gjatë hetimit administrativ<sup>26</sup>, subjekti ka shpjeguar se shumica prej 800.000 lekësh përbëhet nga kursimet e vitit 2005 të krijuara nga paga e tij dhe e bashkëshortes të cilat së bashku me huanë, u përdorën për blerjen e tokës objekt analize në fund të vitit 2005. Subjekti me atë rast është shprehur se çdo kursim i akumuluar gjatë viteve 2004-2005, është shpenzuar gjatë vitit 2005.

12.13. Komisioni po ashtu ka konkluduar se bazuar në vlerën provuese që kanë deklaratat periodike vjetore, sipas përcaktimit të nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, në kushtet që subjekti ka deklaruar të kursyer gjatë vitit dhe gjendje në dhjetor 2005 një shumë prej 800.000 lekë, pretendimi i subjektit se në fakt kjo shumë është përdorur për pasurinë objekt analize nuk është i bazuar. Komisioni ka argumentuar se deklarimi i kësaj shume në DIPP-2005, ka pasqyruar gjendjen faktike të situatës në datën 31.12.2005.

12.14. Në përgjigje të barrës së provës për mospërputhjen e mësipërme mes shpjegimeve të fundme në proces krahasuar me deklarinimet ndër vite dhe në ILDKPKI, për mënyrën e përdorimit të kursimit të deklaruar për vitin 2005, subjekti ka pretenduar se ka qenë i paqartë në ILDKPKI në vitin 2008 dhe ka kërkuar që të pranohet versioni i deklaruar në pyetësorë se këto kursime nuk kanë qenë pjesë e *cash*-it të deklaruar në deklaratën për vitin 2007 si gjendje në total prej 3.050.000

---

<sup>24</sup> Nga një analizë ushtrimore e kryer për të shteruar këtë shkak ankimi, balanca negative e huadhënësit, duke mbajtur në konsideratë vetëm aktet e kohës për të ardhurat e tij e bashkëshortes dhe zbritur vetëm shpenzimet e jetesës, balanca negative rezulton në vlerën (-) 786.259 lekë përkundër asaj të reduktuar të përlllogaritur në Komision.

<sup>25</sup> Me anë të deklaratës datë 16.07.2008 (me shënimin PV 2007), përcjellë në Komision nga ILDKPKI me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 09.11.2023.

<sup>26</sup> Përgjigjet e pyetësorit nr. 2, përgjigjja nr. 4/(i).

lekësh<sup>27</sup>. Subjekti i ka kërkuar Komisionit që të mbajë në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit se kontrolli i pasurisë fillon nga deklarata *vetting* dhe ka referuar vendimin e Kolegjit nr. 20/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Irena Gjoka. Sipas tij, deklaratimet ndër vite dhe në deklaratën *vetting* janë në unitet me njëra – tjetrën. Në ankim subjekti i rivlerësimit ka ngritur të njëjtat pretendime sikurse në Komision. Sipas tij, përfshirja e kësaj shume në analizën financiare të vitit 2005, ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe vjen në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit,<sup>28</sup> sipas të cilës gjendja *cash* përlllogaritet sipas deklaratimeve në deklaratat periodike vjetore dhe deklaratën *vetting*.

**12.15.** Bazuar në sa më sipër evidentuar, trupi gjykues i Kolegjit vëren se, për sa i përket burimit të dytë të krijimit të kësaj pasurie, *kursime nga paga*, varianti i fakteve të pretenduara nga subjekti në procesin e rivlerësimit, bie ndesh me deklaratat periodike vjetore që kanë vlerë provuese në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit 84/2016 apo me shpjegimet në zbatim të ligjit nr. 9049/2003. Konkretisht, trupi gjykues i Kolegjit, konstaton se subjekti nuk ka specifikuar në deklaratën *vetting* se cilave vite i përkasin pagat që shërbyen si burimi tjetër i krijimit të kësaj pasurie, ndërsa në deklaratën periodike për vitin 2005 nuk ka specifikuar, qoftë edhe indirekt, *kursimet nga pagat* si burim për blerjen e tokës në Sauk. Përkundrazi, në atë deklaratë, subjekti është shprehur se kishte *gjendje cash* në 31.12.2005 “*likuiditetin kursime prej 800.000 lekësh*”. Po ashtu, disa muaj më pas, në korrik 2008, subjekti ka deklaruar nën përgjegjësi në ILDKPKI, se gjendja *cash* prej 2.450.000 lekë e deklaruar në mars 2008, përfshinte kursimet prej 800.000 lekë të deklaruara si gjendje në 31.12.2005.

**12.16.** Për rrjedhojë, është i bazuar konkluzioni i Komisionit për konsiderimin e kësaj shume si jo të shpenzuar, por si gjendje *cash* në fund të vitit 2005. Në analizën e kryer në Kolegj, versioni i ndryshuar gjatë hetimit administrativ sipas të cilit përdorimi i shumës 800.000 lekë është zhvendosur mbrapsht në kohë, u konsiderua si përpjekje për t’ia përshtatur situatës në rivlerësim dhe jo si pasqyrim i së vërtetës. Këto akte me vlerë provuese, nuk mbështesin pretendimin e subjektit për ta konsideruar të shpenzuar/si burim për tokën, shumën 800.000 lekë. Nga kontrolli i analizës financiare, bazuar në argumentet e mësipërme, konfirmohet *pamjaftueshmëria* e burimeve për krijimin e gjendjes *cash* prej 800.000 lekësh e deklaruar si gjendje në fund të vitit, referuar deklaratës periodike për vitin 2005.

**12.17.** Në kontrollin e analizës financiare të Komisionit lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare të subjektit në funksion të blerjes së pasurisë objekt analize, përveç dy aspekteve të analizuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti ka parashtruar edhe që ka përfituar një shpërblim për shkak të një procedimi penal me shkallë të lartë vështirësie dhe

---

<sup>27</sup> Shumatorja e dy gjendjeve *cash* të deklaruara në DIPP-2007, 2.450.000 lekë, me burim të ardhurat nga shitja e apartamentit, dhe 600.000 lekë me burim kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

<sup>28</sup> Subjekti referon vendimin nr.20/2022 të subjektit të rivlerësimit Irena Gjoka dhe vendimin nr. 28/2022, të subjektit të rivlerësimit Ludovik Dodaj.

që duhet të reduktohen e zbriten shpenzimet mjekësore për vajzën në Stamboll dhe shpenzimet e udhëtimit në Turqi.

**12.18.** Shpërblimi i përfituar dhe i padokumentuar gjatë vitit 2004, pretendohet vetëm në parashtrimet shtesë në Kolegj. Mbi të gjitha, ky pretendim është tërësisht deklarativ. Përpos që nuk pretendon një vlerë konkrete të këtyre të ardhurave, subjekti konfirmon edhe që nuk disponon dokumentacion provues. Për të provuar ekzistencën e këtij shpërblimi, subjekti ka depozituar me parashtrimet shtesë në Kolegj disa akte, përfshirë edhe tre fragmente videosh të marra nga burime të hapura<sup>29</sup>, që i përkasin një procedimi penal me disa të pandehur<sup>30</sup>. Edhe duke abstraguuar nga fakti që këto akte nuk përmbushin kërkesat përjashtimore të provave të reja që lejohen me ankimin, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, trupi gjykues vlerëson se nuk kanë asnjë vlerë provuese në drejtim të pretendimit të subjektit se ka përfituar shpërblim financiar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të hetimit të kësaj çështjeje penale dhe disa të tjerave të një rëndësie të veçantë. Subjekti ka qenë pjesë e sistemit të prokurorisë deri kur Komisioni ka marrë vendimin objekt ankimi. Në këto rrethana, është e pritshme që ai të kishte gjetur akte e dokumente që qoftë edhe indirekt do ta bënin të besueshëm këtë përfitim, duke filluar nga vlera e akorduar, qoftë edhe në raport me rrogën mujore ose si përqindje e saj, nëse nuk ka disponuar shifrën e saktë – sikurse as nuk e ka deklaruar më parë. Për rrjedhojë, parashtrimi i vonë i këtij pretendimi, ndërthurur me mungesën në tërësi të detajeve, e bëjnë të pamundur pranimin e pretendimit për të shtuar të ardhura të tjera, të paspecifikuara në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara gjatë kohës kur ai krijoi pasurinë objekt analize.

**12.19.** Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit në ankim për mënyrën e përllogaritjes së *shpenzimeve mjekësore të vajzës* janë pranuar nga Komisioni sipas kërimit të tij, pas kalimit të barrës së provës, dhe vlera prej 137.858 lekësh i është përfshirë analizës së vitit 2006. Komisioni e ka referuar në narrativë këtë qëndrim edhe në vendim, në paragrafin 36.4. e për rrjedhojë, ky aspekt i pretendimit konsiderohet i ngritur pa shkak dhe vlerësohet pa relevancë për shqyrtimin në Kolegj.

**12.20.** Sa i përket pretendimit për të reduktuar shpenzimet e udhëtimit në Turqi, rezulton se në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se në datën 24.03.2005 ka udhëtuar në Stamboll me bashkëshorten dhe kanë qëndruar pesë (5) ditë tek një i afërm i subjektit, i cili në atë kohë *kryente studimet* në Stamboll. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion bashkëlidhur këtij pyetësin. Në kuadër të barrës së provës, subjekti depozitoi deklaratën noteriale<sup>31</sup> të këtij personi [z. A. G.], hartuar në datën 11.03.2024, që nënkupton pas njohjes me rezultatet e hetimit në datën 22.02.2024<sup>32</sup>. Përmes kësaj deklarate, rikonfirmohen shpjegimet e subjektit. Referuar jurisprudencës së Kolegjit, deklaratat noteriale jo të kohës, të hartuara për efekt të procesit të

<sup>29</sup> *Kronika të televizionit kombëtar Klan.*

<sup>30</sup> *Cituar në poshtëshënimin nr. 4 të këtij vendimi të Kolegjit.*

<sup>31</sup> *Nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.03.2024.*

<sup>32</sup> *Referuar paragrafëve 9 dhe 10 të vendimit të Komisionit, rezulton se subjekti është njohur me rezultatet e hetimit në datën 22.02.2024 dhe ka paraqitur shpjegimet e provat në datën 20.03.2024, për të prapësuar barrën e provës.*

rivlerësimit, nuk mund të kenë vlerë provuese, të vetme, nëse nuk shoqërohen me akte të tjera që konfirmojnë përmbajtjen e tyre. Në rastin konkret, subjekti nuk ka depozituar akte që provojnë rezidencën në Stamboll të deklaruesit A. G.. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime e dokumentacion as mbi mundësinë akomoduese dhe financiare të pritësit për të përballuar shpenzimet e qëndrimit të subjektit dhe bashkëshortes, në kushtet që ishte student, e që nënkupton mundësi financiare modeste.

12.21. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit për të *reduktuar shpenzimet e udhëtimit në Turqi*, meqenëse ato janë mbuluar nga një i afërm, student në Stamboll, u vlerësua i pambështetur në akte. Në kushtet që pritësi referohet të ketë qenë student/i papunësuar në periudhën në fjalë, si dhe që subjekti nuk ka depozituar akte që provojnë mundësinë e tij financiare për të mbuluar shpenzime qëndrimi e akomodimi të subjektit e bashkëshortes, ndërkohë që pritësi prezumohet të ketë pasur mundësi financiare modeste, dhe as lejen e qëndrimit të tij për të plotësuar kuadrin e rrethanave faktike, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos reflektuar në analizë uljen e pretenduar për shpenzimet në fjalë.

12.22. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, konfirmohet vlera negative përfundimtare e analizës së kryer nga Komisioni prej (-) 2.336.019 lekësh. Trupi gjykues çmon të theksojë që edhe në një variant *alternativ*, ushtrimor, të kryer për të shteruar në tërësi të gjitha aspektet përcaktuese të shkaqeve të ankimit për këtë pasuri, përfshirja në analizë *pjesërisht* e huadhënies nga personi tjetër i lidhur në kufijtë e vlerës së mundësisë të kursimit nga huadhënësi, bilanci do të rezultonte gjithsesi negativ. Konkretisht, balanca negative në atë variant do të shkonte në vlerën (-) 1.543.061 lekë<sup>33</sup>.

12.23. Në përfundim, nga kontrolli i analizës financiare dhe i pretendimeve të subjektit, *u konfirmua edhe në Kolegj*, konkluzioni i Komisionit për *mungesë burimesh të ligjshme*, për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi. Bilanci financiar për këtë pasuri, mbeti sërish negativ edhe pas pranimit të disa të ardhurave të huadhënësit/personi tjetër i lidhur, të cilat u gjetën të provuara me dokumentacion. Për rrjedhojë, për këtë pasuri trupi gjykues vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e *nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016*.

II. *Pasuria shtëpi banimi [dy kate dhe garazh], ndodhur në Sauk, Tiranë, në vlerën 5 milionë lekë*

13. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar se në tokën e ndodhur në Sauk, ka ndërtuar një shtëpi banimi me dy kate, me sipërfaqe 248 m<sup>2</sup> dhe një garazh me sipërfaqe 30 m<sup>2</sup>, për të cilën ka aplikuar për legalizim në datën 14.11.2006. Ndërtimi i shtëpisë ka filluar në vitin 2006 dhe ka vazhduar për disa vite. Po aty, subjekti deklaroi se vlera e pasurisë është rreth 5 milionë lekë dhe

<sup>33</sup> Kjo vlerë është rezultat aritmetik i zbritjes nga shuma e pretenduar e huasë, prej 1.200.000 lekë, e shumës së pamundësisë financiare të huadhënësit, prej (-) 407.042 lekë, për ta financuar atë. Vlera që përftohet do të ishte 792.958 lekë e cila së bashku me balancën negative që përftohet për kursimet e mundshme dhe pasuritë e krijuara nga subjekti në vitin 2005, passjell shumën (-) 1.543.061 lekë.

që si burim kanë shërbyer kursimet e tij familjare dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në Elbasan me kontratën noteriale të datës 16.11.2007. Referuar deklaratimeve të subjektit, dokumentacionit bashkëlidhur deklaratës *vetting*<sup>34</sup>, atij të përcjellë nga ish ALUIZNI<sup>35</sup> dhe AShK-ja<sup>36</sup>, si edhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ<sup>37</sup>, rezulton se mbi tokën e ndodhur në Sauk, subjekti i rivlerësimit ka ndërtuar *pa* leje ndërtimi, një shtëpi banimi, e cila në bazë të lejes së legalizimit, datë 07.08.2023, është regjistruar në datën 18.09.2023, në regjistrat e pasurive të paluajtshme, në pronësi individuale të subjektit të rivlerësimit.

**13.1.** Komisioni vlerësoi përfundimisht se subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme, në shumën (-) 2.099.057 lekë, për krijimin e kësaj pasurie. Subjekti nuk ka provuar burimet e ligjshme. Ky vlerësim erdhi si rrjedhojë e mospërmbysjes së rezultateve të hetimit administrativ se: (i) nuk përputhen deklaratimet e subjektit për burimet financiare që kanë shërbyer për krijimin e ndërtesës; (ii) subjekti nuk ka deklaruar depozitën në Alpha Bank, në deklarin e tij të parë në vitin 2003 e në vijim, në emër të bashkëshortes, dhe ka balanca negative prej (-) 1.598.762 lekësh për krijimin e depozitës në vitin 2001, dhe (-) 387.860 lekë për vitin 2003; (iii) subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për ndërtimin e shtëpisë si rrjedhojë e këtyre balancave negative, sikurse edhe asaj të vitit 2006 prej (-) 900.568 lekësh për krijimin e kursimeve të subjektit dhe bashkëshortes që janë investuar në ndërtimin e shtëpisë.

**13.2.** Në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e mësipërm me të njëjtat pretendime sikurse edhe në përgjigje të rezultateve të hetimit. Pretendimet kanë për fokus periudhat dhe koston e ndërtimit të banesës si edhe burimet që kanë shërbyer për krijimin e saj. Konkretisht, në mënyrë të përmbledhur, subjekti potencon se: (i) Kostoja e ndërtimit të shtëpisë nuk është në vlerën 6,4 milionë lekë të përlllogaritur nga Komisioni, por është rreth 5,9 milionë lekë, e cila është shpenzuar gjatë periudhës 2006-2008; (ii) Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar saktë burimin e krijimit të kësaj pasurie. Në këto kushte, mungesa e deklaratimit të burimeve në deklaratat periodike të pasurisë, duhet konsideruar si një pasaktësi me karakter formal dhe pa pasoja në procesin e rivlerësimit; (iii) Mosdeklarimi i depozitës prej 3 milionë lekësh të krijuar në vitin 2001 pranë Alpha Bank, në deklaratën para fillimit të detyrës dhe atë periodike, duhet konsideruar si një pasaktësi e ndrequr jashtë procesit të rivlerësimit, përpara fillimit të këtij procesi. Duke mbajtur në konsideratë mjaftueshmërinë financiare për krijimin e saj, kjo pasaktësi duhet të konsiderohet formale dhe pa pasoja në procesin e rivlerësimit. Sipas aktit të ekspertimit të audituesit ligjor, subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh në vlerën (-) 58.678 lekë për krijimin e depozitës së vitit 2003, balancë e cila nuk mund të penalizojë subjektin, sipas parimit të proporcionalitetit. Të ardhurat e krijuara nga ish firmat piramidale duhet të përfshihen të plota, në përputhje me vlerat e përcaktuara në mandatet e depozituara prej subjektit.

---

<sup>34</sup> Me deklaratën *vetting*, subjekti ka depozituar për këtë pasuri, formularin e vetëdeklarimit për legalizim me numër {\*\*\*} prot., datë 14.11.2006.

<sup>35</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot, datë 18.07.2017.

<sup>36</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.06.2023.

<sup>37</sup> Me përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dhe me prapësimet.

13.3. Në përfundim të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit dhe pas kontrollit të vendimit të Komisionit për këtë pasuri, edhe në analizën e kryer në Kolegj, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit, vlerëson se subjekti është në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Ky vlerësim u bazua në rrethanat e faktit që rezultuan nga shqyrtimi i pretendimeve të potencuara për periudhat dhe koston e ndërtimit si edhe për burimet e krijimit, sikurse shtjellohet në vijim.

a. *Pretendime në lidhje me periudhat dhe koston e ndërtimit*

13.4. Pasi fillimisht e vlerësoi koston sipas çmimit të referencës të Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”) për vitin 2006 në total bashkë me garazhin, në shumën 7,1 milionë lekë, në vijim të prapësimeve të subjektit, Komisioni zbriti disa zëra. Si pasojë e kësaj qasjeje, nga rishikimi i analizës financiare të vitit 2006, vlera e investimit rezultoi në shumën 5,1 milionë lekë, ndërsa vlera totale e investimit të shtëpisë me 2 kate, rezultoi rreth 6,4 milionë lekë. Në pikën 48.3 të vendimit, Komisioni ka arsyetuar se ka zbritur nga kostoja e ndërtimit për vitin 2006, vlerat e fitimit të planifikuar dhe të fondit rezervë. Po ashtu, shpenzimet në vitet 2007 dhe 2008 janë vendosur sipas deklaratimit të subjektit në deklaratat periodike përkatëse.

13.5. Në ankim, subjekti ka ngritur të njëjtat pretendime me ato të barrës së provës, duke kërkuar që vlera e ndërtimit të përlllogaritet në 5.970.830 lekë. Ndërsa në pikën 70 të parashtrimeve të depozituara në Kolegj, subjekti e ka reduktuar koston edhe më tepër, duke pretenduar se nëse i zbritet edhe vlera e TVSh-së së pagueshme dhe vlerat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për m<sup>2</sup>, për punëtorët, vlera totale e investimit do të ishte 5.424.401 lekë. Subjekti kërkon edhe që shpenzimet të shtrihen gjatë periudhës 2006 - 2008. Referuar jurisprudencës së Kolegjit<sup>38</sup>, sipas tij, Komisioni duhej të kishte zbritur nga kostoja edhe vlerat e TVSh-së, fondit rezervë, fitimit të planifikuar, kosto të administrimit të kantierit etj. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka depozituar një raport të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme të datës 20.09.2023, i cili u administrua nga Komisioni në cilësinë e provës.

13.6. Pasi i analizoi pretendimet e mësipërme në raport me aktet që administrohen në dosjen e Komisionit dhe nën dritën e jurisprudencës të Kolegjit, trupi gjykues i vlerësoi pretendimet në lidhje me përlllogaritjen e koston së ndërtimit dhe shpërndarjes së shpenzimeve për këtë qëllim në vitet 2006, 2007 dhe 2008 sipas raporteve të pretenduara në ankim, të pambështetura në akte. Në vijim, arsyetimi mbi të cilin u bazua ky konkluzion.

13.7. *Së pari*, subjekti ka pranuar se nuk disponon dokumentacion të kohës për të provuar shpenzimet e kryera për këtë investim. I vetmi akt i paraqitur prej subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim, është raporti i vlerësimit të ndërtesës, i hartuar nga një inxhinier i kontraktuar prej tij, për nevoja të procesit të rivlerësimit. Njëjtë si në Komision, ky akt ekspertimi edhe në Kolegj, nuk mori vlerë provuese pasi nuk është akt i kohës, dhe siç rezultoi e shprehur që në hyrje të aktit,

---

<sup>38</sup> Subjekti referon vendimin nr. 6, datë 17.03.2022 që i përket subjektit të rivlerësimit Hysen Keta dhe vendimin nr. 7, datë 29.03.2022 të subjektit Sulejman Kurti.

është hartuar nga eksperti në përgjigje të kërkesave të klientit/subjektit, duke u bazuar në standardet profesionale dhe në besueshmërinë e klientit. Ky akt ekspertimi rezulton i pacertifikuar nga ndonjë autoritet publik, por i kryer në funksion të procesit të rivlerësimit. Për këto arsye, njëjtë si Komisioni edhe Kolegji kreu përllogaritjen duke aplikuar tarifat e përcaktuara nga aktet nënligjore për vitet e ndërtimit, të cilat zbatohen nga EKB-ja për koston sipas sipërfaqes së ndërtimit.

**13.8.** Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratime për këtë pasuri. Konkretisht, në datën 14.11.2006, subjekti ka aplikuar dhe dorëzuar pranë ish ALUIZNI-t, formularin e vetëdeklarimit për legalizimin e banesës me sipërfaqe 244 m<sup>2</sup> dhe një garazhi me sipërfaqe 20 m<sup>2</sup>, me përshkrimin se janë ndërtuar në vitin 2006. Në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2006, subjekti ka deklaruar “shtëpi banimi dy kate me sipërfaqe 248 m<sup>2</sup>, me gjendje ndërtimore “karabina” dhe një garazh me sipërfaqe 30 m<sup>2</sup>, me adresë në Sauk. Po aty, subjekti ka specifikuar vitin 2006 si vit të krijimit, ndërsa pasurinë e ka deklaruar në vlerën 2.950.000 lekë. Në dy deklaratat periodike vjetore në vijim [për vitet 2007 dhe 2008], subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzime për vazhdimin e ndërtimit të shtëpisë, respektivisht në vlerën 800.000 lekë për vitin 2007 dhe 500.000 lekë për vitin 2008. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar shtëpinë e banimit objekt vlerësimi, me vlerë 5 milionë lekë. Sipas deklarimit, ndërtimi ka filluar në vitin 2006 dhe ka vazhduar për disa vite. Ndërsa gjatë hetimit administrativ në Komision<sup>39</sup>, subjekti ka shpjeguar se ndërtimi i banesës ka filluar në vitin 2006, vit në të cilin është kryer edhe pjesa më e madhe e punimeve, ndërsa në vitet 2007 dhe 2008, janë kryer punime të brendshme, në shumat e deklaruara prej subjektit. Në vitet në vijim, është kryer ndonjë punim rifiniture me vlera të vogla. Subjekti është shprehur edhe se kjo banesë është ndërtuar në mënyrë informale dhe nuk disponon situacione të ndërtimit. I njëjti qëndrim konfirmohet edhe në raportet kundër rezultateve të hetimit.

**13.9.** Në dosjen e Komisionit nuk administrohet ndonjë informacion i Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor, i cili të referojë të dhëna në lidhje me periudhën e ndërtimit të godinës 2-kateshe. Ndërsa në aktin e ekspertimit të dorëzuar në Komision nga subjekti, eksperti konfirmon se referuar gjeoportalit ASIG, ndërtesa objekt kontrolli është ndërtuar para vitit 2007, pasi në fotografimin ajror të kryer në mars 2007, objekti është i ndërtuar si volum ndërtimor. Vërehet që në këtë akt, eksperti nuk e ka pasqyruar fragmentin e fotografimit ajror për vitin 2006 apo atë të marsit 2007, por pasqyron vetëm fragmentin e fotografimit ajror të vitit 2018.

**13.10.** Në përmbledhje të sa më sipër, rezulton se konstatimi i Komisionit për të përllogaritur shpenzimet sipas referencës së EKB-së për koston duke u bazuar në vitin 2006, është i bazuar. Ky moment në kohë përkon me deklarin e subjektit ndër vite, për banesën dhe garazhin, qoftë në formularin e aplikimit për legalizim datë 14.11.2006, të dorëzuar pranë ALUIZNI-t, ashtu edhe në deklaratën periodike vjetore për vitin 2006. Në formularin e dorëzuar pranë ALUIZNI-t, në fotografitë e objektit që shoqërojnë praktikën e legalizimit dhe në dokumentacionin e hartuar nga ky institucion [formularë, skica fushore dhe digjitale] banesa pasqyrohet si objekt me gjendje ndërtimore të përfunduar dhe jo si karabina, në dallim nga sa subjekti ka pretenduar në deklaratën

---

<sup>39</sup> Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, përgjigja nr. 5/i dhe 5/ii.

periodike. Ky moment në kohë përkon edhe me shpjegimet e dhëna në procesin e rivlerësimit se nuk disponon dokumentacion provues, por *pjesa më e madhe* e punimeve është kryer *në vitin 2006*, ndërsa në vitet 2007 dhe 2008, janë kryer punime të brendshme në shumat e deklaruara prej subjektit apo që në vitet në vijim, janë kryer punime me vlera të vogla. Fakti i ndërtimit të objektit përpara vitit 2007, konfirmohet edhe nga eksperti i kontraktuar nga subjekti.

**13.11.** Komisioni ka arsyetuar qartë metodologjinë e përlllogaritjes së kostos së ndërtimit duke bazuar në të dhënat teknike të pasurisë, çmimin e referencës të EKB-së për vitin 2006, së cilës i ka zbritur vlerat e fitimit të planifikuar dhe të fondit rezervë, sipas pretendimit të subjektit dhe jurisprudencës së Kolegjit. Edhe shpenzimet për vitet në vijim 2007 e 2008 janë rillogaritur sipas deklarimeve të deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike të këtyre viteve. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të pambështetur në akte, pretendimin e subjektit për një kosto më të ulët përkundër asaj të përlllogaritur nga Komisioni mbi bazën e çmimeve të referencës të EKB, së cilës pretendohet se i duheshin zbritur edhe vlerat e TVSh-së, fondit rezervë dhe të fitimit të planifikuar.

**13.12.** Në kushtet e mungesës së dokumentacionit të kohës që provon shpenzimet faktike të kryera për ndërtimet informale, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të drejtë e të bazuar përlllogaritjen e kostos së ndërtimit në Komision, sipas çmimeve të referencës të publikuara nga Enti Kombëtar i Banesave. Raporti i vlerësimit të pasurisë i depozituar gjatë hetimit administrativ, është dokument hipotetik i hartuar mbi bazën e standardeve profesionale dhe pretendimeve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit e për pasojë, nuk mund të argumentohet se mund të provojë vlerën reale të ndërtimit të objektit. Trupi gjykues vëren se ndryshe nga sa pretendohet në ankim, Komisioni ka pranuar kërkimin e subjektit duke zbritur nga kosto e ndërtimit, vlerat e fondit rezervë dhe të fitimit të planifikuar, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit<sup>40</sup>.

**13.13.** Në linjë me këtë qasje dhe me vendime të mëparshme të Kolegjit për situata të ngjashme, kërkimi i subjektit për të zbritur edhe vlerën ekuivalente të TVSh-së për ndërtimin, është i pabazuar. Për sa kohë, kjo vlerë ka qenë pjesë përbërëse automatike e çmimeve të aplikuara, për të cilat janë kryer edhe pagesat nga subjekti tregtar pranë të cilit subjekti ka blerë materialet për ndërtimin e objektit, ky kërkim është i pakuptimtë. Referuar nenit 1, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, “*Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) paguhet: a. për të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve të kryera kundrejt pagesës prej një personi të tatueshëm, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë*”. Për rrjedhojë, trupi gjykues vëren se kërkimi i subjektit, edhe duke abstraguuar nga momenti kur është ngritur, apo fakti që është në vazhden e kërkimeve deklarative për uljen e çmimit, të pabazuara në akte, është i pabazuar.

---

<sup>40</sup> *Shih, ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 6, datë 17.03.2022, pika 14.7, që i përket subjektit të rivlerësimit Hysen Keta.*

13.14. I pabazuar në akte u vlerësua edhe kërkimi i subjektit për ta shpërndarë koston e ndërtimit në vitet 2006-2008, në të njëjtin raport me deklaratimet e tij në deklaratat periodike të pasurisë. *Së pari*, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit për mungesë arsyetimi në vendimin e Komisionit sa i përket kërkimit për shtrirjen e koston së ndërtimit ndër vite. Ndryshe nga sa pretendon subjekti, kostoja e ndërtimit pas kalimit të barrës së provës, është shpërndarë në vitet 2006-2008, duke rillogaritur koston e ndërtimit për vitin 2006 dhe në vijim, edhe shpenzimet e deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore për vitet 2007 dhe 2008. E thënë ndryshe, ndonëse nuk është artikuluar në mënyrë të shprehur nga Komisioni, shpërndarja e koston në këto vite rezulton e qartë dhe e kuptueshme.

13.15. *Së dyti*, shpërndarja e shpenzimeve të ndërtimit ndër vite, në kushtet që mbështetet në aktet e kohës të administruara në fashikull, është qasje e bazuar. Konkretisht, në deklaratimin për legalizim, datë 14.11.2006, të subjektit tek ish-ALUIZNI, në deklaratën periodike për vitin 2006 dhe në ato të dy viteve në vijim, subjekti ka referuar përkatësisht vitin 2006 si *vit ndërtimi* dhe shpenzime për *vazhdimin e ndërtimit* të shtëpisë për vitin 2007 dhe 2008. Në të njëjtën linjë, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se ndërtimi i banesës ka filluar në vitin 2006, *vit në të cilin është kryer edhe pjesa më e madhe e punimeve*, ndërsa në vitet 2007 dhe 2008, janë kryer punime të brendshme në shumat e deklaruara. Nga këto aspekte, deduktohet se është i drejtë vlerësimi i Komisionit se vlera totale e investimit është 6,4 milionë lekë, nga e cila 5,1 milionë lekë janë shpenzimet e kryera në vitin 2006, ndërsa shuma 1,3 milionë lekë përfaqëson vlerat e shpenzuara në vitet 2007 dhe 2008, të deklaruara në mënyrë të shprehur nga subjekti në deklaratat periodike vjetore të këtyre viteve.

13.16. *Së fundmi*, edhe në një version *alternativ* të analizës financiare për vitet 2006-2008, duke përdorur koeficientë të zbatuar në vendime të mëparshme të Kolegjit në të cilat është përllogaritur 44.46 % e koston totale të ndërtimit në vitin 2006, referuar deklaratimit të subjektit në deklaratën periodike për vitin 2006 se ndërtesa ishte në fazën e *karabinasë*, dhe duke shpërndarë diferencën e vlerës në mënyrë të barabartë në dy vitet në vijim – duke mos mbajtur në konsideratë shpenzimet e deklaruara shprehimisht nga subjekti në deklaratat periodike të viteve 2007 e 2008 – situata financiare do të përmbysesh pozitivisht për vitin 2006, por do të përkeqësohej *ndjeshëm*, për vitet 2007-2008. Gjithsesi, trupi gjykues në analizën për këtë aspekt të shkaqeve të ankimit, iu referua harkut kohor dhe shpjegimeve të subjektit në deklaratat periodike vjetore.

b. *Pretendime në lidhje me burimet për krijimin e banesës 2-katëshe*

13.17. Sikurse përmbledhur më sipër, në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar si burime krijimi të kësaj pasurie (i) kursimet familjare dhe (ii) të ardhurat nga shitja e apartamentit në Elbasan në vitin 2007. Ndërsa në deklaratat periodike të viteve 2006, 2007 dhe 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm shumat e shpenzuara në ato vite për ndërtimin e banesës, por pa specifikuar burimet prej të cilave rridhnin shumat e deklaruara. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se shpenzimet e kryera në vitin 2006 për ndërtimin e banesës, janë përballuar me kursimet e depozituara në Alpha Bank, e konkretisht: një depozitë prej 3 milionë lekësh në emër

të tij dhe bashkëshortes dhe një tjetër depozitë prej 1 milion lekësh në emër të tij, bashkëshortes dhe vajzës së tyre.

**13.18.** Komisioni ka vlerësuar përfundimisht se subjekti nuk ka provuar burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Edhe pas reflektimit të disa pretendimeve të pranuar pas kalimit të barrës së provës, analiza financiare përfundimtare rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme, në shumën prej (-) 2.099.057 lekësh. Nga analiza financiare e kryer në Komision, subjekti rezultoi me mungesë burimesh për krijimin e kursimeve familjare për shkak të (i) balancës negative në vlerën (-) 1.598.762 lekë për krijimin të depozitës prej 3 milionë lekësh në emër të tij dhe të bashkëshortes, të çelur në vitin 2001 pranë Alpha Bank (tashmë OTP Bank); (ii) balancë negative prej (-) 387.860 lekësh për depozitën e krijuar në vitin 2003 në emër të subjektit, bashkëshortes dhe vajzës së tyre; (iii) balancës negative në vlerën (-) 900.568 lekë për kursimet nga paga për vitin 2006. Ndërsa në lidhje burimin tjetër e konkretisht për të ardhurat nga shitja e apartamentit në Elbasan, Komisioni nuk rezulton të ketë veçuar problematika, ndonëse referon edhe që subjekti nuk ka shpjeguar përfitimin e një vlere mbi 10 herë më të lartë nga shitja, krahasuar me blerjen<sup>41</sup>.

**13.19.** Subjekti ka ankimuar konkluzionin e Komisionit për kursimet familjare, duke risjellë në fokus të njëjtat pretendime me ato të potencuara në prapësimet kundër rezultateve të hetimit. Nga shqyrtimi i ankimit dhe i parashtrimeve, vërehet se pretendimet e subjektit kanë për fokus kryesisht depozitën bankare të vitit 2001, ndërsa për dy burimet e tjera [depozitën e vitit 2003 dhe kursimet nga paga] potencon vetëm balancën negative të konkluduar nga Komisioni. Në ankim dhe në parashtrimet shtesë në Kolegj, subjekti pretendon se ka deklaruar saktë, ndërsa pasaktësitë në deklaratat periodike duhet konsideruar të karakterit formal, pa pasoja në procesin e rivlerësimit. Konkretisht, kjo qasje duhet të gjejë zbatim për mosdeklarimin e depozitës prej 3 milionë lekësh, në vitin 2001 pranë Alpha Bank, në deklaratën para fillimit të detyrës dhe atë periodike. Ai ka pasur mundësi me burime financiare të ligjshme, për krijimin e depozitës në fjalë me: (i) të ardhurat nga punësimi i tij. Sipas subjektit, Komisioni ka bërë përlllogaritje të gabuar pasi nuk ka përfshirë të ardhurat e përfituara nga ana e subjektit përpara vitit 1995, në vlerën 174.271 lekë; (ii) Komisioni nuk ka pranuar të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes për periudhën 1997- korrik 2001, të ardhurat nga pagat e subjektit deri në korrik 2001 dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Elbasanit në vitin 1998, të cilat janë përfituar në masën 100 % vetëm nga subjekti. Ndryshe nga ankimi, në parashtrimet shtesë në Kolegj, subjekti shprehet se Komisioni i ka marrë në konsideratë këto të ardhura; (iii) të ardhurat nga interesat bankare deri në këtë periudhë; (iv) të ardhurat nga firmat piramidale, të cilat duhen pranuar të plota sipas shumave të referuara në mandatet respektive. Nga analiza financiare e kryer nga audituesi ligjor, rezulton vetëm një balancë negative prej (-) 58.678 lekësh për krijimin e depozitës në vitin 2003. Në këtë analizë janë përfshirë

---

<sup>41</sup> Subjekti rezulton ta ketë blerë këtë apartament për 500.000 lekë në vitin 2003, dhe shitur për 5,9 milionë lekë në vitin 2007. Shitja e këtij apartamenti ka gjeneruar të ardhura për blerjen e një njësie shërbimi në Elbasan, në vlerën 2.650.000 lekë në vitin 2007 dhe pjesa tjetër, deklaruar për shtëpinë objekt analize. Komisioni nuk ka konstatuar asnjë problematike për këto pasuri, pavarësisht se në paragrafin 24.10 dhe 24.12 konstaton përkatësisht se nuk ka hetuar për arsyen përse vlera e apartamentit ka ndryshuar në këtë përpjesëtim.

të ardhurat nga firmat piramidale, vlera e plotë e shitjes së banesës në shumën 700.000 lekë si dhe ulja e shpenzimeve jetike në masën 30 % të të ardhurave, sipas jurisprudencës së të Kolegjit në vendimin nr. 15/2021.

**13.20.** Trupi gjykues i Kolegjit, i gjeti të pabazuara pretendimet sa më sipër. Nga kontrolli i analizës financiare të *burimeve që kanë shërbyer për ndërtimin e banesës dy-katëshe*, subjekti dhe bashkëshortja rezultuan edhe në Kolegji *me mungesë të burimeve të ligjshme, për krijimin e dy depozitave pranë Alpha Bank*, përkatësisht 3.000.000 lekë në korrik të vitit 2001 dhe 1.000.000 lekë në shtator të vitit 2003. Trupi gjykues e gjeti të bazuar qëndrimin e Komisionit për të përfshirë në analizën e burimeve të ligjshme të ardhurat nga ish-firmat piramidale, *vetëm në vlerën e përfituar nga subjekti e bashkëshortja*, sipas mandat pagesave. Nga ana tjetër, ndonëse vëren se përfituarja e gjithë vlerës së përfituar nga shitja e apartamentit në Elbasan në vitin 1998, pavarësisht se subjekti nuk është i vetmi pronar i tij, përbën *një favorizim tjetër të subjektit nga Komisioni*, për garanci procedurale ndaj subjektit, u përfshi e gjitha në analizën financiare në Kolegji. Zërat e tjerë të potencuar nga subjekti i rivlerësimit, nuk e përmbysin balancën negative. Ky konkluzion i Kolegjit, u bazua në situatën faktike dhe ligjore që rezultoi nga shqyrtimi i pretendimeve në raport me aktet që administrohen në dosje, dispozitat ligjore që gjejnë zbatim dhe jurisprudencën e Kolegjit, shtjelluar në detaj në vijim të këtij vendimi.

*ii/a Depozita 3 milionë lekë, pranë Alpha Bank, në emër të subjektit dhe bashkëshortes*

**13.21.** Nga analiza financiare e kryer në Komision, subjekti rezultoi me një balancë negative prej (-) 1.598.762 lekësh për krijimin e kësaj depozite. Komisioni ka pranuar të përfshijë në analizë financiare: (i) ardhurat nga firmat piramidale *vetëm në shumën 132.000 lekë* të provuar me mandatet në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij dhe (ii) *shumën 700.000 lekë* nga shitja në vitin 1998 e apartamentit në qytetin e Elbasanit. Gjithashtu, *ka pranuar të reduktojë shpenzimet e jetesës për periudhën 1994-1998*, duke i përlllogaritur ato në masën 30% të të ardhurave. Nga shqyrtimi i llogarive bankare, Komisionit i rezultoi që kjo depozitë është çelur në datën 25.01.2001, në emër të bashkëshortes së subjektit, përmes depozitimit të shumës në *cash* prej 2,5 milionë lekësh. Në datën 05.08.2003, fondet e depozitës janë transferuar në llogarinë dyemërore të subjektit dhe bashkëshortes, pranë së njëjtës bankë dhe në datën 18.03.2004, këto fonde bashkë me interesat e akumuluar, janë transferuar në llogarinë e vjehrrit të subjektit të rivlerësimit.

**13.22.** Komisioni ka konstatuar se bazuar në shpjegimet e subjektit, për ndërtimin e banesës në vitin 2006 janë përdorur kursimet e depozituara në Alpha Bank në vitin 2002. Subjekti ka shpjeguar që shumën 3.271.123 lekë, e akumuluar deri në vitin 2003 në llogarinë e përbashkët të tij dhe të bashkëshortes, e transferuan në mars të vitit 2004 në llogarinë e vjehrrit në Alpha Bank, për marrjen e një vize në ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në janar të vitit 2006, këto fonde iu kthyen subjektit dhe bashkëshortes. Vjehri i subjektit e ka tërhequr *cash* të gjithë depozitën përpara afatit, në datën 20.01.2006. Komisioni konstatoi mospërputhje ndërmjet deklaratës *vetting* dhe deklarimeve periodike vjetore, pasi në këto të fundit, subjekti nuk ka

deklaruar destinacionin e depozitës pas tërheqjes në vitin 2006 dhe nuk rezulton t'i ketë përdorur për ndonjë investim tjetër.

**13.23.** Në ankim, subjekti parashtron të njëjtat pretendime me ato në prapësimet kundër rezultateve të hetimit. Subjekti kërkon përfshirjen e të ardhurave nga ish-skemat piramidale në analizë financiare me vlerat që referojnë disa mandate të sjella prej tij. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka depozituar një shkresë, datë 04.03.2024, të Ministrisë së Financave në lidhje me mandatet e firmave piramidale dhe funksionin e një personi, [z. S. E.] si administrator i firmës “{\*\*\*}”. Po ashtu, subjekti depozitoi edhe një akt ekspertimi të hartuar nga një auditues ligjor.

**13.24.** Trupi gjykues vëren se, konstatimi i Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat periodike të kohës – qoftë depozitën e krijuar në vitin 2001 e të transferuar në mars 2004 në llogarinë e vjehrrit të tij, por edhe destinacionin e përdorimit të saj pas tërheqjes në vitin 2006 – është i drejtë. Për më tepër, deklarimi i vetëm njëherës nga depozitat [ajo në vlerën 1 milion lekë] dhe jo i depozitës në fjalë prej 3 milionë lekësh, është evidentuar edhe nga ILDKPKI-ja, e cila i ka kërkuar subjektit të shpjegojë shkakun e mosdeklarimit. Sipas shpjegimit të subjektit<sup>42</sup>, mosdeklarimi ka qenë për shkak se në 28.03.2004 [data e dorëzimit të deklaratës së parë të pasurisë], ai nuk e ka pasur gjendje depozitën. Subjekti shprehet se në atë kohë, ka menduar se duhej të deklaronte vetëm pasuritë që dispononte gjendje deri në datën 28.03.2004 të plotësisimit të këtij formulari dhe jo të atyre që kishte disponuar në fund të vitit pararendës, pra deri në datën 31.12.2003. Për të njëjtën arsye ai nuk e ka deklaruar këtë depozitë as në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2004.

**13.25.** Trupi gjykues evidenton një aspekt që e çmoi me rëndësi në drejtim të besueshmërisë së shpjegimeve. Konkretisht, në datën 18.03.2004, *10 ditë para dorëzimit të deklaratës së parë të pasurisë* [më datë 28.03.2004], depozita në fjalë është transferuar në llogari të vjehrrit të subjektit pretenduar në funksion të procedurave administrative për marrjen e vizës në ambasadë, për t'iu rikthyer subjektit pas dy vitesh në janar 2006. Përkundër këtyre shpjegimeve, pavarësisht se kjo depozitë iu transferua vjehrrit, në thelb përbënte *pasuri të subjektit* – një detyrim i një pale të tretë ndaj tij – dhe si e tillë, duhet të gjente pasqyrim në deklaratën e parë të pasurisë, qoftë edhe me përshkrimin e kësaj rrethane. Nga ana tjetër, vërehet se veprimi i transferimit i kryer në një moment kohor që i paraprin vetëm me 10 ditë deklarimit të pasurisë, përbën të njëjtën tipologji veprimesh me ato të një tjetër depozite dyemërore në emër të bashkëshortes së subjektit dhe babait të saj [analizuar në vijim]. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se është i saktë konstatimi i Komisionit se subjekti kishte detyrim të deklaronte depozitën çelur nga bashkëshortja e tij në vitin 2001 në vlerën *3 milionë lekë*, e cila *nuk* është deklaruar as në deklaratën për herë të parë të pasurisë në datën 28.03.2004 dhe as në atë vijuese, për vitin 2004, në kuptim të ligjit nr. 9049/2003. Në kushtet që në procesin e rivlerësimit në fokus është deklarata *vetting*, kjo pasaktësi u vlerësua vetëm në funksion të kontrollit të burimeve të ligjshme.

---

<sup>42</sup> Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 09.02.2006.

**13.26.** Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se, pretendimi i subjektit se i është cenuar parimi i sigurisë juridike, është i pabazuar. Ky pretendim ka për bazë argumentin se Komisioni ka hetuar për një çështje që përbën “gjë të gjykuar”, meqenëse prokuroria ka vlerësuar se mosdeklarimi i saj nuk përmban elementë të veprave penale të fshehjes së pasurisë apo të deklarimit të rremë. Nga aktet në fashikull, rezulton se në ngarkim të tij, ka nisur një procedim penal bazuar në një kallëzim të ILDKPKI-së në vitin 2006<sup>43</sup>. Prej tyre, rezulton se prokuroria nuk ka kryer një analizë financiare të sajën, apo të jetë mbështetur në ndonjë analizë financiare të hartuar nga ekspertë të fushës për verifikimin e mundësisë së subjektit për krijimin e depozitës. Kontrolli i ligjshmërisë së krijimit të kësaj depozite është mbështetur *kryesisht* në deklaratimet e subjektit. Në aktet në fashikull mungon informacioni nëse vendimi i pushimit të procedimit penal është ankimuar nga ILDKPKI-ja – me fjalë të tjera, i është nënshtruar kontrollit gjyqësor.

**13.27.** Në analizë të këtyre rrethanave ligjore e faktike, pretendimi i subjektit se Komisioni nuk mund të hetonte për depozitën bankare të referuar më sipër, në kushtet që ajo deklarohet si një ndër burimet e krijimit të pasurisë objekt analize, është i pakuptimtë. Në linjë me arsyetimin e zgjeruar të Kolegjit në një çështje tjetër, po ashtu që kishte për fokus rivlerësimin e një prokurori, trupi gjykues vëren se për shkak të natyrës së ndryshme që ka procedimi penal krahasuar me një proces administrativ, sikurse edhe për faktin që vendimi i pushimit është vendim i prokurorisë, është e pamundur të argumentohet se një vendim i prokurorisë përbën gjë të gjykuar pasi nuk përmbushet kriteri i parë – nuk është vendim gjyqësor<sup>44</sup>. Çmojmë të theksojmë këtu, si argument dytësor edhe faktin që për konstatimin se mungon vepra penale, prokuroria nuk rezulton të jetë mbështetur në një analizë financiare por në deklaratimet e subjektit për kontrollin e ligjshmërisë së krijimit të kësaj depozite.

**13.28.** Për sa i përket aspektit tjetër, të ardhurave nga ish-firmat piramidale, subjekti potencon që ka depozituar tri shuma prej 90.000 lekësh secila, ku për secilin investim ka përfituar shumë më 288.000 lekë. Kjo nënkupton se për secilin investim subjekti ka përfituar 198.000 lekë fitim ose një total prej 594.000 lekësh. Ndonëse në këto mandate janë shënuar emrat e familjarëve të subjektit, sipas praktikës së brendshme të atij fondacioni, në fakt të gjitha depozitimet dhe tërheqjet janë kryer prej tij. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen këtë pretendim të pabazuar në aktet që administrohen në dosjen e Komisionit. Subjekti ka shpjeguar në Komision<sup>45</sup> se depozita bankare prej 3 milionë lekësh, objekt kontrolli, është krijuar ndër të tjera, edhe me të ardhurat e përfituara nga investimi në ish-firmat piramidale. Në mbështetje të pretendimit të tij, subjekti depozitoi tri

---

<sup>43</sup> Subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. 4 ka përcjellë në vëmendje të Komisionit dosjen penale nr. {\*\*\*}, datë 28.02.2006, që i përket procedimit penal të filluar ndaj tij. Nga aktet rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Librazhd, në bazë të kallëzimit penal të depozituar në vitin 2006 nga ILDKPKI-ja, ka kryer hetime në lidhje me këtë depozitë bankare.

<sup>44</sup> Shih ndër të tjerë, vendimin nr. 37/2023 (JR) të Kolegjit për çështjen që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit B. Lleshi në [https://kpa.al/ep-content/uploads/2024/07/Vendim-i-anonimizuar\\_SR-Lleshi\\_word.pdf](https://kpa.al/ep-content/uploads/2024/07/Vendim-i-anonimizuar_SR-Lleshi_word.pdf).

<sup>45</sup> Me përgjigjet e dërguara me e-mailin e datës 22.12.2023, përgjigjet e pyetësorit nr. {\*\*\*} prot. dhe me prapësimet kundër rezultateve të hetimit.

mandatarkëtime, një deklaratë noteriale<sup>46</sup> të hartuar gjatë procesit të rivlerësimit [më datë 24.01.2024] dhe një shkresë të Ministrisë së Financave, drejtuar subjektit. Në këtë shkresë<sup>47</sup>, konfirmohet se mandatet e paraqitura nga subjekti janë me formë e natyrë të njëjtë me ato që ndodhen në dosjet e kreditorëve të këtyre shoqërive. Në këtë shkresë konfirmohet edhe funksioni i z. S. E.. Ky i fundit, në deklaratën noteriale, shprehet se mandat arkëtimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, janë plotësuar prej tij në cilësinë e ish-drejtorit të filialit Peqin të fondacionit “{\*\*\*}”.

**13.29.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi se emrat e familjarëve të subjektit janë shënuar “formalisht” sipas praktikës së brendshme të atij fondacioni, përpos që mbeti në nivel deklarativ, vlerësohet edhe i pakuptimtë, parë edhe në logjikën bazike të interesit ekonomik të vetë individit që investon, për të shtuar emra personash që nuk kanë asnjë kontribut monetar. Edhe më pak logjikë ekonomike përbën për fondacionin, të cilit i interesonte akumulim fondesh pavarësisht titullarit. Në këto kushte, qëndrimi i Komisionit për të përfshirë në analizë financiare *vetëm* vlerën që ka përfituar subjekti dhe bashkëshortja [132.000 lekë], është i bazuar. Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit për efekt të përlllogaritjes së një vlerë në total prej 594.000 lekësh nga tre mandate, përfshirë edhe ato në mandatet ku titullarët e cituar janë persona të ndryshëm, është deklarativ dhe i paprovuar me dokumentacion. Për rrjedhojë, nga ky burim të ardhurash u përfshinë në analizë shumatorja e dy pjesëve takuese, 132.000 lekë<sup>48</sup>.

**13.30.** Ndryshe nga sa pretendon subjekti referuar raportit të audituesit ligjor të pajtuar prej tij, edhe në Kolegji konfirmohet balanca negative e përlllogaritur në Komision qoftë për burimet e ligjshme të disponuara për të krijuar depozitën e vitit 2001, ashtu edhe për depozitën e vitit 2003. Balanca negative nuk është vetëm ajo e vitit 2003 që, sipas subjektit, është në një vlerë modeste prej (-) 58.678 lekësh e, për pasojë, jopenalizuese. Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, rezulton një balancë negative prej (-) 768.041 lekësh dhe (-) 448.990 lekësh, përkatësisht për depozitën e krijuar në vitin 2001 dhe atë të krijuar në vitin 2003. Për rrjedhojë, subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë disponuar burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitave në fjalë, të cilat pretendohen si burim për ndërtimin e pasurisë objekt analize. Në këtë analizë, u përfshinë në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara: (i) të ardhurat e subjektit për vitin 1994; (ii) të ardhurat e përfituara nga firmat piramidale në shumën 132.000 lekë në vitin 1996; (iii) shpenzimet e jetesës

---

<sup>46</sup> Nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.01.2024.

<sup>47</sup> Nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2024.

<sup>48</sup> Konkretisht, (i) mandat pagesa me numër {\*\*\*}, datë 30.12.1996, konfirmon pagesën e shumës 288.000 lekë në favor të përfituesve B. K. (30), M. K. (30) dhe Dritan Gripshi (30). Sipas këtij mandati, shuma e lëvruar është fitimi nga 90.000 lekë, e arkëtuar nga secili prej përfituesve në mënyrë të barabartë. Për rrjedhojë, fitimi që i korrespondon subjektit të rivlerësimit është 1/3 e shumës totale prej 288.000 lekësh, ose 96.000 lekë. Duke i zbritur kësaj shume, vlerën e investuar [30.000 lekë] fitimi real i subjektit do të ishte 66.000 lekë. (ii) Edhe mandatpagesa me numër {\*\*\*}, datë 30.12.1996, konfirmon pagesën e shumës 288.000 lekë në favor të tre përfituesve, një prej të cilëve është bashkëshortja e subjektit. Fitimi që i korrespondon është 66.000 lekë. (iii) Mandatpagesa me numër {\*\*\*}, datë 30.12.1996, nuk referon asnjë të dhënë për përfitim nga subjekti apo bashkëshortja. Për rrjedhojë, nuk ka asnjë peshë për të provuar të ardhura të subjektit dhe bashkëshortes.

për periudhën 1994-1999 u përlllogaritën në nivelin 30% të të ardhurave; (iv) në mbrojtje të garancive procedurale që gëzon subjekti me ankimin, edhe në analizën e kryer në Kolegj u përfshi e plotë shuma 700.000 lekë e përfituar nga shitja e apartamentit në Elbasan në vitin 1998, ndonëse nga subjekti nuk është i vetmi bashkëpronar<sup>49</sup>.

**13.31.** Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, për ndërtimin e banesës dy-katëshe gjatë periudhës 2006-2008, edhe në Kolegj, subjekti rezultoi me *mungesë* të burimeve financiare për vitin 2006. Balanca negative e konstatuar në Kolegj, prej (-) 1.725.608 lekësh, është e konsiderueshme. Në këtë analizë, sikurse edhe Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit nuk ka përfshirë efektin financiar që do të kishte shlyerja e huasë për huadhënësin [z. S. V.] në vlerën 1.200.000 lekë. Nëse analiza do të kryhej sipas logjikës standarde financiare, duke përfshirë edhe shlyerjen e huasë – që Komisioni nuk ka arsytuar përse nuk e ka mbajtur – balanca negative e vitit 2006 do të rezultonte më e thellë. Gjithashtu, nuk është përfshirë as shuma prej 3.000 eurosh të pretenduar të dhuruar subjektit nga një kushëri, në vitin 2006 [analizuar në vijim]. Së fundmi, sikurse referuar edhe më sipër, trupi gjykues i Kolegjit nënvizon se edhe në versionin alternativ të përlllogaritjes dhe shpërndarjes së kostos së ndërtimit në vitet 2006 deri 2008<sup>50</sup>, subjekti do të rezultonte përsëri me bilanc negativ, i cili do të zhvendosej në vitet 2007-2008<sup>51</sup>.

### *III. Dhurim në vlerën 3000 euro në vitin 2006 nga kushëri*

**13.32.** Në deklaratën periodike për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *dhuratë* në shumën 3000 euro, dhënë nga djali i xhaxhait, z. Sh. G.. Subjekti nuk e ka deklaruar këtë dhurim në deklaratën *vetting*, por me përgjigjet e pyetësorit standard dhe në pyetësorë. Konkretisht, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se dhuruesi, ka qenë administrator i një personi juridik [{"\*\*\*"}], të themeluar që në vitin 2001 dhe depozitoi dokumentacion<sup>52</sup>.

**13.33.** Nga analiza financiare *paraprake* rezultoi se dhuruesi *nuk* justifikonte me burime të ligjshme shumën e dhuruar subjektit në vitin 2006. Po ashtu, ndërsa fillimisht Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për rezultatin financiar negativ si dhe për konstatimin për dyshime për veprime fiktive të kryera nga subjekti për të justifikuar investimet në vitet në vijim, pas prapësimeve të tij, Komisioni përfshiu në mesin e të ardhurave të këtij personi *tjetër* të lidhur, të ardhurat e

---

<sup>49</sup> Subjekti ka depozituar në Komision deklaratë të nënës së tij, sipas të cilës të ardhurat nga shitja e apartamentit i ka përfituar tërësisht vetëm ai, duke përjashtuar gjithë bashkëpronarët e tjerë që tërhiqnin të drejta.

<sup>50</sup> Nëse kostoja e ndërtimit për vitin 2006 do të përlllogaritej si karabina, sipas deklaramit periodik vjetor 2006 dhe diferenca do të shpërndahej në mënyrë të barabartë në dy vitet 2007 dhe 2008 .

<sup>51</sup> Sipas këtij versioni alternativ, viti 2006 do të rezultonte me balancë pozitive 1.679.343 lekë, viti 2007 me balancë negative prej (-) 676.906 lekësh dhe viti 2008 me balancë negative prej (-) 1.174.276 lekësh.

<sup>52</sup> Me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti depozitoi aktet: (i) certifikatë familjare të dhuruesit Sh. G.; (ii) një ekstrakt të QKR për subjektin tregtar [{"\*\*\*"}] ShPK; (iii) vërtetim për bazën e vlerësueshme datë 10.11.2023 për të siguruarin Sh. G. për periudhën 2005 – 2011. Në vijim të këtij pyetësori, me dokumentin shpjegime shtesë, protokolluar në Komision në datë 08.01.2024, subjekti ka depozituar edhe një shkresë të DRT Elbasan nr. [{"\*\*\*"}] prot, datë 21.11.2023 drejtuar Sh. G., bashkëlidhur së cilës janë pasqyrat financiare dhe formularët e deklaramit të tatimit mbi fitimi për vitet 2004, 2005, 2006, ndërsa konfirmon mungesën e të dhënave për vitet 2001 dhe 2002.

bashkëshortes së tij, sikurse edhe të ardhura nga vetëpunësimi në bujqësi. Komisioni ka rishikuar analizën financiare duke *përfshirë* pagën neto minimale të dhuruesit si i vetëpunësuar në bujqësi dhe pagat neto të bashkëshortes së tij, sipas konfirmimit të ISSh-së. Pavarësisht nga shtesa e këtyre burimeve financiare, dhuruesi rezultoi gjithsesi me mungesë burimesh të ligjshme për shkak të një balance negative prej (-) 216.012 lekësh për të krijuar shumën 3000 euro, dhuruar subjektit. Sipas Komisionit, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e dyshimit për veprime fiktive të subjektit me qëllim justifikimin e burimeve të ligjshme, rrethanë e cila u vlerësua se e rëndon pozitën e subjektit në këtë aspekt.

**13.34.** Në ankim dhe parashtrimet shtesë në Kolegj, subjekti potencon të njëjtat pretendime sikurse në prapësim të rezultateve të hetimit. Subjekti pretendon se dhuruesi kishte të ardhura nga paga dhe nga toka bujqësore. Këto të fundit janë të ligjshme dhe sipas përlllogaritjes në aktin e ekspertimit rezultojnë se janë mbi 300.000 lekë, më se të mjaftueshme për të krijuar shumën e dhuruar. Sipas subjektit, dhuruesi që nga viti 1994 figuron si i vetëpunësuar në bujqësi. Kontributet e derdhura për periudhën 1999-2004, provojnë zhvillimin realisht të aktivitetit bujqësor. Subjekti e konsideron të palogjikshëm qëndrimin e Komisionit për veprime fiktive. Subjekti i ka kërkuar Komisionit të mbajë në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit<sup>53</sup>, për dhurimet me peshë të vogël nga familjarët. Për të provuar pretendimet, subjekti depozitoi bashkëlidhur prapësimeve si edhe në seancë dëgjimore, dokumentacion mbështetës<sup>54</sup>.

**13.35.** Pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit, analizuar nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit për përfshirjen në analizën financiare të shumës prej 3.000 eurosh të pretenduar të dhuruar atij nga një kushëri, në vitin 2006. Edhe në analizën e kryer në Kolegj, dhuruesi/personi tjetër i lidhur rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për të kontribuar shumën e pretenduar dhuruar subjektit të rivlerësimit edhe duke abstraguuar nga qëndrimi favorizues që ka zgjedhur Komisioni duke pranuar akte në të cilat nuk pasqyrohet viti i pagesës së kontributeve për dhuruesin si i vetëpunësuar në bujqësi. Ky fakt duhet të ishte hetuar për të përjashtuar dyshimin që dhuruesi mund të mos ketë derdhur kontribute në vitin 2006, apo që nuk përbënte përpjekje të subjektit për ta shëruar këtë situatë gjatë periudhës së procesit të rivlerësimit, në funksion të legjitimitit të këtyre të ardhurave. Ky vlerësim u bazua në situatën faktike që rezultoi nga shqyrtimi i akteve që administrohen në dosjen e Komisionit, shtjelluar në vijim.

---

<sup>53</sup> Referuar vendimin e Kolegjit nr. 15/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Kastriot Selita.

<sup>54</sup> Subjekti ka depozituar në Komision pas rezultateve të hetimit: (i) vërtetim për të vetëpunësuarin në bujqësi të dhuruesit Sh. G. për periudhën 1999-2004; (ii) AMTP dhe kartelë pasurie për një tokë në emër të tij; (iii) vërtetim, datë 20.03.2024, të Njësisë Administrative Gjocaj për përfitimin nga dhuruesi të tokës bujqësore, kultivimin me kultura të ndryshme bujqësore dhe për pagimin rregullisht të taksave vendore; (iv) akt ekspertimi për llogaritjen e të ardhurave nga pronësia bujqësore për familjen e dhuruesit gjatë periudhës 1 janar 1994-31 dhjetor 2004; (v) vërtetim për bazën e vlerësuar, datë 18.03.2024, për të bashkëshorten e kushëritit për vitin 2005 si edhe vërtetimet e barrëlindjes.

**13.36.** Trupi gjykues vëren *së pari*, Komisioni nuk ka arsyetuar mbi të ardhurat prej 300.000 lekësh të pretenduara nga përdorimi i tokës bujqësore sipas aktit të ekspertimit. Në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, subjekti nuk ka provuar me dokumente të kohës, realizim faktik të ardhurash nga veprimtaria bujqësore qoftë edhe thjesht në planin ekzistencial, çka përjashton diskutimin në vijim edhe në plan ligjshmërie. Ndryshe nga raste të tjera të trajtuara në Kolegj [përfshirë edhe ato të referuara nga subjekti në ankim], në rastin e subjektit/dhuresit, vlera e të ardhurave të pretenduara nga veprimtaria bujqësore nuk i referohet akteve të kohës (për shembull licenca, fatura, mandate etj.) të cilat mund të hidhnin dritë mbi ushtrimin realisht të veprimtarisë bujqësore, realizimin e produkteve bujqësore dhe përfitimin e të ardhurave nga shitja e tyre subjekteve tregtarë që operonin me grumbullimin dhe përpunimin e prodhimeve nga kjo veprimtari bujqësore. Subjekti i referohet vetëm një akti ekspertimi të përpiluar me kërkesë të tij, gjatë procesit të rivlerësimit. Ky akt nuk mund të ketë vlerë provuese jo vetëm për shkak të kohës kur është hartuar, por edhe sepse vlerat e referuara në të janë tërësisht hipotetike/teorike, pasi nuk duket të pasqyrojnë asgjë nga aktet e kohës. Përpiluar duke u bazuar mbi të dhëna statistikore dhe manualet në këtë fushë, ky akt përfaqëson më shumë sesa një realitet të bazuar në të dhëna, nevojat e subjektit në procesin e rivlerësimit.

**13.37.** *Së dyti*, trupi gjykues i Kolegjit vëren edhe në këtë aspekt një qasje favorizuese të Komisionit i cili ka pranuar pagën minimale të dhuresit si i vetëpunësuar në bujqësi sipas vërtetimit të kontributeve shoqërore të lëshuar nga ISSh Elbasan, pa asnjë rezervë, dhe pa kryer asnjë hetim mbi faktin që në kolonën e parë të vërtetimit të ISSh-së nuk ka të dhënë të vitit kur janë shlyer kontributet. Njëjtë si në rastin e huadhënësit [z. S. V., trajtuar në lidhje me tokën e blerë në Sauk], Komisioni duhet të kishte hetuar për të përjashtuar dyshimin që kontributet e personit tjetër të lidhur nuk janë shlyer vetëm për efekt të përpjekjeve të subjektit për të krijuar perceptimin e likuiditeteve të mjaftueshme, nga burime të ndryshme, në favor të tij për krijim pasurish. Nëse Komisioni do të kishte hetuar për legjitimitetin e kontributeve nga të afërm e familjet e tyre, për subjektin, do të verifikohej edhe nëse veprimet e kryera pasqyrojnë ligjërim në mënyrë prapavepruese të burimeve të deklaruara prej subjektit, i cili deklarohet në kahun përfitues për efekt krijimi pasurish, ndonëse kontribuuesit rezultojnë me të ardhura modeste, të vetëpunësuar në bujqësi familjarisht, në mënyrë të përsëritur dhe burimet me të cilat ata financojnë pasuritë e subjektit, shtohen në procesin e hetimit administrativ.

**13.38.** *Së treti*, nga kontrolli i ushtruar në Kolegj mbi analizën financiare të mundësisë për dhurimin e shumës 3.000 euro, rezulton se Komisioni ka përfshirë në analizë të ardhura në nivelin e pagës minimale nga vetëpunësimi i dhuresit në bujqësi. Në fakt, pagat referencë për të vetëpunësuarit në bujqësi janë më të ulëta se pagat e kategorive të tjera. Konkretisht në vitin 2005, paga për të vetëpunësuarit në bujqësi rezulton të jetë 4.500 lekë në muaj. Nëse në analizën për personin tjetër të lidhur/dhuresin do të përfshihej kjo pagë, bilanci negativ do të rezultonte rreth (-) 670.000 lekë përkundrejt balancës prej (-) 216.012 lekësh të rezultuar në Komision. Megjithatë në respektim të garancive procedurale që gëzon subjekti me ankimin, edhe në analizën e kryer në Kolegj pagat si i vetëpunësuar në bujqësi u reflektuan sipas vlerave të Komisionit. Në përfundim edhe nga

kontrolli financiar në Kolegj, rezultoi se personi tjetër i lidhur nuk kishte burime të mjaftueshme financiare për të financuar dhuratën në shumën 3.000 euro. Për rrjedhojë, kjo shumë iu ngarkua ekonomisë familjare të subjektit për vitin 2006.

#### *IV. Autoveturë “Mercedes Benz”, vit prodhimi 2002*

14. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar autoveturën me të dhënat e referuara më sipër, të blerë në datën 17.03.2016, kundrejt çmimit 2.100 euro. Në këtë deklaratë, subjekti nuk ka deklaruar burimet e krijimit. Në deklaratën periodike të vitit 2016, subjekti ka deklaruar si burim kursimet nga pagat e tij dhe të bashkëshortes ndër vite. Në pyetësin standard, subjekti është shprehur sërish se burim janë kursimet, dhe çmimi 284.063 lekë<sup>55</sup>.

14.1. Bazuar në balancën negative prej (-) 33.000 lekësh, të rezultuar nga analiza përfundimtare, Komisioni konkludoi se subjekti nuk ka provuar burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Nga shqyrtimi i dy deklaratave të pasurisë për vitin 2015 [deklarata para fillimit të detyrës dhe deklarata periodike e pasurisë], Komisionit i rezultoi se subjekti *nuk* ka deklaruar gjendje *cash*. Për rrjedhojë, Komisioni përfshiu në analizë financiare vetëm të ardhurat e realizuara gjatë periudhës janar 2016-mars 2016. Balanca negative fillestare, sipas rezultateve të hetimit ishte në vlerën prej (-) 96.563 lekësh.

14.2. Në ankim dhe në prapësime, subjekti ngre të njëjtat pretendime, duke potencuar si burim, kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes ndër vite. Duke mbajtur në konsideratë balancat pozitive në vitet 2011-2016 dhe veçanërisht balancën pozitive të vitit 2015, subjekti pretendon që balanca negative për blerjen e automjetit duhet të vlerësohet si jopenalizuese, nën dritën e parimit të proporcionalitetit.

14.3. Duke e analizuar këtë pretendim në raport me deklaratimet e subjektit vlerësuar nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim dhe me jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues vëren *së pari*, se në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar vetëm blerjen e automjetit por jo burimet financiare, duke mos përmbushur detyrimin ligjor në rivlerësim, nën dritën e pikës 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenet 30, 31, 32 të ligjit nr. 84/2016 e shtojcën 2 bashkëlidhur ligjit, si dhe me udhëzimin nr. 4095, datë 10.10.2016 i miratuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016. Këto dispozita përcaktojnë qartë detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për të deklaruar me saktësi dhe vërtetësi çdo pasuri, duke mos lejuar vend për harresa apo forma të tjera pakujdesie, për shkak të rëndësisë që ka deklarata *vetting*, në vijimin e karrierës së subjekteve.

14.3.1. *Së dyti*, ndërsa subjekti ka cilësuar si burim kursimet nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, ndër vite, në deklaratën përpara fillimit të detyrës, në vitin 2015, dhe në atë periodike për të njëjtin vit, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*-i kursimesh. Për rrjedhojë, nën dritën e dispozitave të ligjit nr. 9049/2003, për të deklaruar *gjendjen e kursimeve në formë likuiditetesh cash apo në*

---

<sup>55</sup> Blerja dhe pronësia e subjektit për automjetin në fjalë, konfirmohet nga dokumentacioni bashkëlidhur deklaratës *vetting* dhe ai i përcjellë në Komision nga DPShTRr, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.07.2021.

*bankë, në fund të çdo viti*, pasqyruar në formularin përkatës<sup>56</sup>, qartazi për mënyrën e deklarimit sipas ligjit, pretendimet për kursime të disponuara e të padeklaruara, në linjë me gjuhën e qartë të ligjit, vlerën provuese që kanë deklaratat periodike vjetore dhe jurisprudencën e Kolegjit<sup>57</sup>, janë të pabazuara. Ekzistenca e kursimeve *nuk mund të prezumohet* nga organet e rivlerësimit, mbështetur vetëm në pretendimin për balanca pozitive të disa viteve të periudhës objekt kontrolli, por duhet të jetë evidentuar në deklaratat periodike të interesave, të cilat shërbejnë si provë në këtë proces, në bazë të parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe që janë prova e vetme mbi të cilën provohet ekzistenca e një pasurie, siç janë likuiditetet *cash* në banesë, që më pas luajnë një rol kyç në paraqitjen e situatës financiare të subjektit të rivlerësimit, kur pretendohen se kanë ekzistuar dhe se kanë shërbyer si burim për krijimin e një pasurie.

14.3.2. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se balancat pozitive të analizës financiare për vitet 2011-2016 dhe veçanërisht ajo e vitit 2015, duhej të konsiderohen si mundësia e tij reale për kursim, pavarësisht se nuk është deklaruar, është jo vetëm në kundërshtim me ligjin, por dhe alogjik në kuptim të përlllogaritjes së këtyre të ardhurave për procesin e rivlerësimit. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nga kontrolli i analizës financiare sipas pretendimeve të potencuara nga subjekti i rivlerësimit, *u konfirmua edhe në Kolegj*, konkluzioni i Komisionit se subjekti ka pasur *mungesë* të burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit, në datën 17.03.2016. Sipas kësaj analize rezulton se subjekti gjendet në mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit në datën 17.03.2016, me një balancë negative në vlerën (-) 72.502 lekë, kundrejt balancës së Komisionit prej (-) 96.563 lekësh në rezultatet e hetimit apo përkundër vlerës (-) 33.521 lekë, të konkluduar përfundimisht në vendim.

14.3.3. Në kushtet që në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2015 dhe në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2015, subjekti *nuk* ka deklaruar gjendje *cash*, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për të përfshirë në analizën financiare të këtij automjeti, vetëm të ardhurat e realizuara gjatë periudhës janar 2016-mars 2016. Balanca negative e konstatuar për këtë pasuri, ndonëse jo e konsiderueshme, nuk është e vetmja. Për rrjedhojë, ajo është e pamjaftueshme për të parashtruar nevojën për zbatimin e parimit të proporcionalitetit, sikurse pretendon subjekti i rivlerësimit. Për sa kohë në vlerësimin e pasurisë subjekti rezulton me një bilanc negativ të konsiderueshëm, konstatimi për këtë pasuri, nuk mund të vlerësohet veçmas nga pasuritë e tjera, apo të përbjë shkak përcaktues për zgjidhjen e çështjes.

---

<sup>56</sup> Formularët e deklarimit të pasurisë të miratuar nga ILDKPKI, përmbajnë shpjegime orientuese për subjektet lidhur me mënyrën e deklarimit dhe udhëzojnë: “Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesat/pakësimet) [...] të çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit”.

<sup>57</sup> Shih ndër të tjerë, vendimin (JR) nr. 7/2025, të subjektit të rivlerësimit Ilir Turja.

*V. Depozita bankare dyemërore prej 4 milionë lekësh e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe babait të saj*

15. Kjo depozitë e padeklaruar nga subjekti në deklaratën *vetting*, është evidentuar gjatë hetimit administrativ. Në ndryshim nga rezultatet paraprake të hetimit, Komisioni e konsideroi këtë depozitë si pasuri në bashkëpronësi të bashkëshortes së subjektit dhe babait të saj, me pjesë të barabarta në masën 50%. Bazuar në balancat negative që rezultuan për secilin bashkëtitullar [bashkëshorten e subjektit dhe babain e saj] për krijimin e pjesës takuese në këtë depozitë, Komisioni vlerësoi përfundimisht se subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë financiare për të krijuar këtë pasuri. Komisioni vlerësoi edhe që kjo depozitë është përdorur nga familja e subjektit, duke mbajtur në konsideratë disa rrethana: (i) mosdeklarimi i kësaj depozite në të njëjtën linjë veprimi edhe me dy depozitat e tjera; (ii) kryerja e veprimeve me vjehrrin; (iii) tërheqja në vitin 2006, që përkon me kohën kur janë kryer pjesa më e madhe e investimeve për shtëpinë e banimit në Sauk.

15.1. Në ankim, subjekti ngre të njëjtat pretendime me ato gjatë hetimit administrativ në Komision. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti potencon që bashkëshortja e tij nuk është pronare/titullare e kësaj depozite, shkak për të cilin nuk e kanë deklaruar në deklaratat periodike. Këto fonde nuk janë përdorur nga subjekti dhe bashkëshortja për krijimin e ndonjë pasurie, fakt i cili provon se nuk është pasuri e tyre. Bashkëshortja e subjektit nuk ka kryer asnjë veprim me këtë llogari, me përjashtim të pranimit të këshillës së punonjësve të bankës për të pasur akses për shkak të moshës së babait të saj. Formulari i aplikimit është nënshkruar nga vjehri, i cili ka kryer të gjitha veprimet në këtë llogari. Ndonëse për disa muaj bashkëshortja ka pasur të drejtën të kryente veprime në llogari bashkë me të atin, më pas ajo nuk ka kryer asnjë veprim. Vjehri i tij nuk duhej konsideruar si person tjetër i lidhur me të. Ndonëse subjekti nuk kishte detyrim të provonte burimin dhe ligjshmërinë e të ardhurave që shërbyen për krijimin e depozitës, ai provoi mundësinë financiare të familjes së vjehrrit për krijimin e kësaj depozite. Për sa kohë kjo depozitë nuk ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie të subjektit dhe as Komisioni nuk e ka konsideruar si pasuri të fshehur të familjes së tij, subjekti i kërkon Kolegjit që shuma 4 milionë lekë e depozituar pranë Tirana Bank, të mos përfshihet në analizën e tij financiare si pasuri e tij.

15.2. Trupi gjykues konstaton se nga kontrolli i vendimit të Komisionit, edhe në analizën e kryer në Kolegj, konfirmohet mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie edhe për pjesën takuese të prezumuar, 2 milionë lekë, që përbëjnë  $\frac{1}{2}$  e vlerës së likuiditeteve që kanë shërbyer për çeljen më 26.11.2003. Në analizën e kryer në Kolegj, efekti financiar i këtij konkluzioni ndikon mbi analizën e vitit 2003, që ka qenë momenti i depozitimit të pjesës takuese të likuiditeteve. Sikurse ka konstatuar edhe Komisioni, vërehet që edhe për këtë pasuri, sikurse dhe për depozitën tjetër të krijuar në vitin 2001, subjekti ka dështuar ta deklarojë në deklaratat periodike të viteve përkatëse, nën dritën e detyrimeve që kishte nga ligji nr. 9049/2003, qoftë në deklaratën e parë apo edhe në deklaratat periodike të kohës.

15.3. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që pretendimet e subjektit për ta konsideruar të gjithë vlerën si pasuri të vjehrrit, mbetën të paprovuara nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, përpos që bien ndesh edhe me dinamikën e krijimit të kësaj depozite në 26.11.2003. Konkretisht, bashkëshortja e subjektit referohet nga aktet bankare të jetë titullare e kësaj llogarie [në Tirana Bank] ndërsa i ati referohet “me të drejta veprimi”, ndërsa ka qenë titullar në një llogari tjetër në të njëjtën bankë. Për më tepër, secili nga llogarimbajtësit rezulton të ketë pasur të drejta veprimi autonome, pa praninë e tjetrit, që nënkupton që të dy llogarimbajtësit kanë tagra të barabarta. Këto fakte provojnë që pretendimi i subjektit se emri i bashkëshortes u shtua si kërkesë nga banka për shkak të moshës “së thyer” të të atit, është i pabazuar. I ati i bashkëshortes ka pasur të njëjtat të drejta si bashkëshortja, dhe shpjegimi i subjektit nuk gjen konfirmim në aktet bankare. Së fundmi, aktet bankare të administruara referojnë saktësisht që llogaria dyemërore i jep tagra të plota e të barabarta secilit prej llogarimbajtësve, si bashkëpronarë e përfitues në rast të vdekjes së tjetrit. Me fjalë të tjera, depozita jo vetëm është hapur nga bashkëshortja e subjektit, por ajo kishte edhe të drejtën ta përfitonte të gjithën në rast vdekjeje të të atit. Për rrjedhojë, nën dritën e përcaktimeve të nenit 199 të Kodit Civil, edhe në Kolegji, depozita u prezumua në pjesë takuese prej ½ pronë e subjektit dhe bashkëshortes.

15.4. Nga ana tjetër, në kushtet që Komisioni ka konkluduar për bashkëpronësi të depozitës dhe cituar në mënyrë të shprehur dispozitën materiale civile si bazë për prezumimin e pjesës takuese prej 1/2, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar përlllogaritjen e gjithë vlerës së saj në ngarkim të subjektit dhe ekonomisë së tij familjare si pikë fundore dhe duke u kufizuar në një arsyetim indirekt në vendim. Në kushtet që Komisioni nuk shprehet për pasuri të fshehur, qoftë edhe indirekt duke mos referuar dispozitat ligjore përkatëse në vendim [pikën 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës apo germën “c”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016], në analizën e kryer në Kolegji, duke mbajtur në konsideratë garancitë procedurale që gëzon subjekti me ankimin, u përfshi vetëm ½ e vlerës së depozitës dy emërore. Nga analiza e kryer për këtë pjesë takuese, subjekti rezultoi me mungesë burimesh që ndonëse e reduktuar kundrejt asaj të përlllogaritur nga Komisioni, nuk pas sjell ndryshim të zgjidhjes së çështjes, pasi balanca negative mbetet e konsiderueshme edhe pas këtij korigjimi. Në vijim, shtjellohet në detaj arsyetimi i Kolegjit mbi të cilën u bazua konkluzioni i mësipërm.

15.5. Trupi gjykues e gjen të pabazuar në akte dhe në ligj, pretendimin se bashkëshortja e subjektit nuk është titullare e depozitës që ka për synim të justifikojë mospërmbushjen e detyrimit të subjektit për ta deklaruar këtë pasuri. Sikurse rezulton nga fakti që edhe depozita tjetër e vitit 2001 nuk është deklaruar, subjekti tregon një vazhde veprimesh që në mënyrë konsistente tregojnë anashkalim të detyrimeve ligjore si subjekt deklarues, sipas ligjit nr. 9049/2003, qoftë në deklaratën e parë apo edhe në deklaratat periodike të kohës. Në këtë konkluzion, janë mbajtur në konsideratë rrethanat e faktit që rezultuan nga shqyrtimi i akteve, parë nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim dhe jurisprudencës së Kolegjit.

15.5.1. Konkretisht, rezulton se kjo pasuri ka ardhur në dijeni të Komisionit gjatë hetimit administrativ. Pa përsëritur çfarë rezultoi nga aktet e përcjella nga Tirana Bank dhe nga shpjegimet e dhëna nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve apo pas kalimit të barrës së provës, trupi gjykues i Kolegjit vëren se dokumentacioni provon të kundërtën e argumenteve e pretendimeve të subjektit. Bashkëshortja e tij jo vetëm nuk ka qenë përfshirë për të ofruar ndihmesë në veprime, por ajo rezulton të ketë qenë (i) *titullare* e llogarisë në të cilën është depozituar në datën 26.11.2003, shuma 4.000.000 lekë ndërsa ishte i ati ai që gëzonte të drejta veprimi në këtë llogari<sup>58</sup>. Për më tepër, i ati ka pasur një llogari tjetër si titullar i vetëm; (ii) bashkëshortja ka çelur depozitën me opsionin me të atin, me tagra të *pavarura* dhe *pa prezencën* fizike të personit tjetër për kryerje veprimesh në këtë llogari<sup>59</sup>. Pra, përveç faktit që llogaria objekt vlerësimi konfirmohet si e çelur nga bashkëshortja e subjektit, konfirmimi se secili prej tyre ka pasur tagër për të kryer *çdo* veprim bankar, në mënyrë të pavarur e pa prezencën fizike të tjetrit, dëshmon të kundërtën e pretendimit se vendosja e emrit të bashkëshortes ishte kërkesë e bankës, si rrjedhojë e moshës së thyer të të atit. Nëse babai i bashkëshortes do të ishte në pamundësi për kryerje veprimesh për shkak të moshës, banka nuk do t'i kishte dhënë tagra për kryerje veprimesh në mënyrë të pavarur dhe pa prezencën fizike të vajzës së tij.

15.5.2. Në dokumentacionin bashkëlidhur shkresave të Tirana Bank evidentohet llogaria në fjalë, dhe depozita e datës 24.11.2003, në emër të dy llogarimbajtësve [E. G. dhe B. I.], me përshkrimin se depozita e përbashkët dyemërore do t'i nënshtrohet dispozitave ligjore që kanë lidhje me “depozitat në llogari të përbashkët” [*joint account*]. Referuar përshkrimit, kjo depozitë jo vetëm që është çelur nga bashkëshortja e subjektit, por është edhe në bashkëpronësi të saj me të atin, madje edhe me të drejtë përfitimi të të gjithë depozitës, në një rast hipotetik të vdekjes së të atit. Sipas kontratës: “*kushdo nga përfituesit [...] mund të përdorë llogarinë, tërësisht ose pjesërisht, pa qenë i nevojshëm bashkëveprimi i të tjerëve. Gjithashtu, secili nga përfituesit depozitues do të ketë të drejtën e përdorimit të pjesshëm ose të plotë të llogarisë pa bashkëveprimin, pëlqimin dhe miratimin e përfituesve të tjerë, madje edhe në rastin e tërheqjes së parakohshme nga depozita me afat. [...] Në rast vdekje të cilitdo përfitues, kjo depozitë si dhe e gjithë llogaria, do të kalojë tek përfituesit e tjerë që janë gjallë deri tek i fundit.*”

15.5.3. Trupi gjykues i Kolegjit, sikurse referuar edhe më sipër në këtë vendim vëren se Komisioni ka mbajtur qëndrim kontradiktor për cilësimin e saktë ligjor të çfarë përbën kjo pasuri. Konkretisht, ngarkimi i gjithë vlerës ekonomisë familjare të subjektit, sikurse ka vendosur Komisioni, nënkupton që sipas Komisionit, e gjithë vlera 4 milionë lekë e depozitës ishte pasuri e fshehur e subjektit dhe bashkëshortes. Kjo duhet të jetë arsyeja e nënkuptuar për të cilën vendimi referon në

---

<sup>58</sup> Referuar shkresave të Tirana Bank, drejtuar Komisionit në datat 26.07.2021 dhe 17.11.2023.

<sup>59</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 13.03.2024, depozituar nga subjekti i vlerësimit me prapësimet kundër rezultateve të hetimit.

paragrafin 69, pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës<sup>60</sup> ndërsa në vijim, në paragrafin 71.7 dhe 71.8 fokusohet vetëm tek *pamundësia* e krijimit të pasurisë me burime të ligjshme dhe mospërmbysja e barrës së provës. Në kushtet që Komisioni ka zgjedhur këtë qasje me një arsyetim të cunguar, duke ia ngarkuar të gjithë shumën ekonomisë familjare të subjektit, pa specifikuar se çfarë nënkupton ky veprim në thelb – fshehje të kësaj pasurie - trupi gjykues i Kolegjit, në konsideratë të garancive procedurale me ankimin, thekson se nga aktet në fashikull, përtej çdo kontestimi, mbetet që më së paku, ½ e kësaj depozite prezumohet t’i përkasë bashkëshortes së subjektit. Në këto kushte, subjekti kishte detyrimin ligjor ta deklaronte këtë depozitë në dy deklaratat periodike të kohës, në mënyrë që t’i nënshtrohej kontrollit për burimet e krijimit dhe mjaftueshmërinë. Ndërsa mosrespektimi i këtij detyrimi e bën deklarin të pasaktë përkundrejt ligjit nr. 9049/2003, në linjë edhe me arsyetimin e mësipërm, ia ngarkoi ekonomisë familjare të subjektit gjysmën e vlerës së depozitës. Nga kjo përllogaritje, subjekti e bashkëshortja rezultojnë me mungesë burimesh për thujtse gjithë vlerën e pjesës takuese, për shkak të një balance negative prej (-) 1.889.747 lekësh në datën e krijimit, 24.11.2003.

**15.6.** Pa përsëritur sa është arsyetuar më sipër për shkaqet për të cilat hetimi i Komisionit për këtë pasuri është qasja e drejtë dhe e bazuar, dhe që vjehri i subjektit nuk është trajtuar si person tjetër i lidhur, trupi gjykues i Kolegjit çmon të shtojë që ka ngjashmëri të konsiderueshme në dinamikën e veprimeve të kryera me këtë depozitë bankare *me dinamikën e referuar për depozitën bankare prej 3 milionë lekësh të çelur në vitin 2001 pranë Alpha Bank [trajtuar më lart]*. Rrethanat e evidentuara e konkretisht: (i) çelja nga bashkëshortja, në datën 24.11.2003, e depozitës të llojit dyemërore në emër të saj dhe babait me tagra të pavarur nga njëri-tjetri; (ii) tërheqja në *cash* nga i ati, i fondeve të depozitës së bashku me interesat e akumuluar, në datën 25 mars 2004 vetëm tri (3) ditë përpara datës 28.03.2004, të dorëzimit të deklaratës për herë të parë të pasurisë dhe ridepozitimi i këtyre fondeve në një tjetër llogari tashmë me titullar të vetëm B. I.; (iii) prishja e depozitës përpara afatit, [në datën 06.01.2006], nga vjehri i subjektit nëpërmjet veprimit të tërheqjes *cash*, të gjithë shumës së krijuar prej 4.396.500 lekësh si edhe (iv) mosdeklarimi i kësaj depozite nga ana e subjektit, me të drejtë e kanë çuar Komisionin në dyshimin e arsyeshëm se kjo depozitë, mund të ishte pasuri e fshehur e tyre. Bazuar në qëndrime të Kolegjit për çështje të kësaj natyre<sup>61</sup>, pavarësisht se babai i bashkëshortes në rastin konkret, nuk përfshihet në rrethin e “personave të tjerë të lidhur” sipas një leximi harmonik të nenit 3, pikat 9 e 14 të ligjit nr. 84/2016, dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, qasja e Komisionit me hetimin, ka qenë e bazuar, sidomos nëse mbahet në konsideratë që më së paku, flitet për bashkëpronësi/bashkinvestim në depozitë. Në këtë kontekst, Komisioni nuk ka tejkalluar kompetencat dhe as i ka ngarkuar subjektit barrë prove

---

<sup>60</sup> “[...] Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. [...]”

<sup>61</sup> Vendimi nr. 15, datë 17.07.2019, paragrafi 110 [SR Dritan Rreshka]; vendimi nr. 22, datë 22.06.2022 [Rilinda Selimi], vendimi nr. 21, datë 10.09.2020, paragrafët 74, 75 [Roland Jaupaj]; vendimi nr. 36, datë 27.07.2023, paragrafi 22 [SR Erarbër Madhi] etj.

të paarsyeshme lidhur me mundësinë financiare të prindërve të bashkëshortes për krijimin e depozitës.

**15.6.1.** Pretendimi i subjektit se ka arritur të provojë me dokumentacion të ardhurat e ligjshme të anëtarëve të familjes vjehrrit, të cilat i mundësuan atij depozitim të shumës 4 milionë lekë me kursimet e dy fëmijëve të tjerë emigrantë, u vlerësua edhe pa relevancë për shqyrtimin e çështjes. Në kushtet që Kolegji prezumon për bashkëpronësi të depozitës dhe që në analizën e kryer në Kolegj ndryshe nga Komisioni, u përfshi vetëm  $\frac{1}{2}$  e vlerës së depozitës dyemërore, 2 milionë lekë, dhe subjekti nuk shpjegoi bindshëm përse veprimet e kryera dhe dinamika e llogarisë provojnë të kundërtën e rolit dytësor të pretenduar prej tij për bashkëshorten në këtë marrëdhënie juridike, trupi gjykues vëren që edhe rrethanat e tjera të prezantuara janë të pabesueshme. Sikurse ka konstatuar Komisioni në paragrafin 71.6 të vendimit, përveç momentit në kohë tejet të avancuar kur subjekti ka depozituar dokumentacionin për të provuar të ardhurat e fëmijëve të tjerë të vjehrrit, ka konstatuar edhe që ata “duket se kanë punuar për të mbushur depozitën e prindërve”. Komisioni nuk argumenton nëse fëmijët e tjerë të vjehrrit kishin mundësi me të ardhura të ligjshme, për të krijuar shumën 4 milionë lekë. Edhe subjekti i rivlerësimit nuk depozitoi asnjë dokumentacion të kohës, *mbi mënyrën e sjelljes të parave në Shqipëri* përpos një *e-mail*-i të kumatës dhe të kumatit, që mbajnë përkatësisht datën 18 dhe 20 mars 2024, të cilët japin detaje deklarative. Shpjegimet e mësipërme të familjarëve të bashkëshortes nuk përbëjnë prova të besueshme në kuptim të pikës 4, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, pasi ato janë në papajtueshmëri me provat e tjera e konkretisht me përgjigjet<sup>62</sup> e subjektit në lidhje me depozitën 3 milionë lekë pranë Alpha Bank [analizuar në shkakun ankimor respektiv], ku subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se në muajin mars të vitit 2004 kishte transferuar në llogarinë e vjehrrit në Alpha Bank shumën 3.271.123 lekë, në funksion të procedurave të aplikimit për marrjen e Vizës për të udhëtuar në Shtetet e Bashkuara. Këto shpjegime e bëjnë të pabesueshëm subjektin se vjehrrit i tij dispononte kursimet e fëmijëve. Nëse vjehrrit i subjektit do t'i posedonte realisht shumat e pretenduara si të sjella nga fëmijët e tij, nuk do të kishte nevojë për këtë transfertë të kryer nga subjekti i rivlerësimit.

**15.6.2.** Në vijim të arsyetimit të bërë në paragrafët më sipër, pretendimet e subjektit për ta konsideruar të gjithë vlerën si pasuri të vjehrrit, mbetën të paprovuara nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, përpos që bien ndesh edhe me dinamikën e krijimit të kësaj depozite në 26.11.2003. Nga ana tjetër, në kushtet që Komisioni ka konkluduar për bashkëpronësi të depozitës dhe cituar në mënyrë të shprehur dispozitën materiale civile si bazë për prezumimin e pjesës takuese prej  $\frac{1}{2}$ , trupi gjykues i Kolegjit e gjen të pabazuar përllogaritjen e gjithë vlerës së saj në ngarkim të subjektit dhe ekonomisë së tij familjare si pikë fundore dhe duke u kufizuar në një arsyetim indirekt në vendim. Në kushtet që Komisioni nuk shprehet për pasuri të fshehur, qoftë edhe indirekt duke mos referuar dispozitat ligjore përkatëse në vendim [pikën 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës apo germën “c”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016], në analizën e kryer në Kolegj, duke mbajtur në konsideratë garancitë procedurale që gëzon subjekti me ankimin, u përfshi vetëm  $\frac{1}{2}$  e vlerës së depozitës dy emërore. Nga analiza e kryer për këtë pjesë takuese,

---

<sup>62</sup> Shpjegimet në pyetësoin nr. 2, përgjigja nr. 4.

subjekti rezultoi me mungesë burimesh prej (-) 1.889.747 lekësh që ndonëse e reduktuar kundrejt asaj të përlogaritur nga Komisioni, nuk passjell ndryshim të zgjidhjes së çështjes, pasi balanca negative mbetet e konsiderueshme edhe pas këtij korrigjimi.

#### *VI. Pretendimet për analizën financiare të periudhës së rivlerësimit 1995-2016*

16. Komisioni konkludoi se pas rishikimit të analizës financiare për periudhën e analizuar 1995–2016, balanca negative paraprake prej (-) 9.454.496 lekësh, e njoftuar me rezultatet e hetimit, u zbut dhe përfundimisht subjekti rezultoi balancë negative prej (-) 8.200.000 lekësh.
17. Subjekti i rivlerësimit kundërshton rezultatit financiar të mësipërm. Sipas tij, balanca tërësore negative është në vlerën (-) 484.581 lekë, e cila maksimalisht do të rritej deri në vlerën (-) 1.094.988 lekë, nëse do të përfshiheshin në analizë financiare edhe shpenzimet për rregullimin e banesës në vlerat 100.000 lekë në vit për periudhën 1998 – 2007. Bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, këto balanca negative, vlerësuar nën dritën e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk mund të shërbejnë si shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit.
18. Në vijim të sa më sipër arsyetuar, pas kontrollit të *analizës së përgjithshme financiare* të kryer nga ana e Komisionit për të gjithë periudhën e rivlerësimit 1994–2016, në Kolegj rezultoi se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, shtesave në likuiditete dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 1994-2016, me një bilanc total negativ prej (-) 6.489.347 lekësh përkundër balancës negative prej (-) 8.120.571 lekësh, të konkluduar nga Komisioni. Në analizën e kryer në Kolegj, u reflektuan disa ndryshime e konkretisht: (i) nga analiza e vitit 2003 u përjashtua vlera 2.000.000 lekë që korrespondon me gjysmën e depozitës bankare dyemërore pranë Tirana Bank, e cila u prezumua se është pronësi e vjehrrit të subjektit; (ii) analiza e vitit 2005 u korrektua duke shtuar vlerën 792.958 lekë që përfaqëson pjesërisht huadhënien nga S. V. deri në vlerën e mundësisë së kursimit nga huadhënësi; (iii) në analizën e vitit 2006 u shtua shlyerja e huasë, huadhënësit S. V.. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit thekson se edhe pas korrektimit të disa zërave të potencuar nga subjekti e të pranuar në Kolegj, balanca negative ndonëse zbutet në raport me atë të rezultuar në Komision, mbetet sërish në nivel të *konsiderueshëm*, ç'ka e përjashton mundësinë e vlerësimit të kriterit të pasurisë nën dritën e parimit të proporcionalitetit.
19. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, nën dritën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vendimi nr. 749, datë 27.03.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj e duhet të lihet në fuqi.

## **PËR KËTO ARSYE,**

trupit gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 749, datë 27.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Gripshi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 09.12.2025.

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Natasha Mulaj**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*